

20101422878

Komisioni i Ligjeve i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

Bazuar në nenin 22 të ligjit “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010) Komisioni i Ligjeve në seancën e mbajtur në datën 19 tetor 2010, miratoi tekstin zyrtar të konsoliduar të ligjit “Për armët”.

Teksti zyrtar i Konsoliduar i ligjit “Për armët” përfshin: Ligjin “Për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/05), ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 47/06), ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 42/07), ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 86/08), ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në ligjin për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 72/10) tek të cilët është përcaktuar afati i hyrjes në fuqi dhe i zbatimit të tyre.

Numër 10-4024/10
25 tetor 2010
Shkup

Kryetar
i Komisionit të Ligjeve
të Kuvendit të Republikës
së Maqedonisë,
Blagorodna Dulik, nënshkrimi

LIGJI PËR ARMËT

(TEKSTI ZYRTAR I KONSOLIDUAR)

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon kushtet për blerjen, posedimin, mbajtjen, ruajtjen, prodhimin, riparimin, paaftësimin (çaktivizimin) tregtimin, transportin dhe transferimin përmes pikave kufitare të armëve dhe municioneve.

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për armët dhe pajisjet ushtarake, si dhe për armët dhe municionet e përcaktuara për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Institucionet Penitenciare dhe organeve të tjera shtetërore dhe subjekteve juridikë të përcaktuar me akte të veçanta.

Neni 2

“Armë”, në kuptimin e këtij ligji konsiderohet çdo objekt ose pajisje e ndërtuar në mënyrë të atillë që, nën presionin e gazeve, të cilat shkaktohen gjatë djegies së lëndëve shpërthyes, gazeve nën presion ose energjive të tjera të mundshme ose ajrit të kompresuar, të hedhë predha në formë plumbi, grumbulli saçmash, gazi, lëngu, shigjete ose substance tjetër që rrezikojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve, si dhe çdo pajisje tjetër qëllimi bazë i së cilës është sulmi mbi integritetin fizik të njerëzve;

Armë, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, janë:

- 1) armët e zjarrit;
- 2) armët e koleksionit;
- 3) armët për vetëmbrojtje;
- 4) armët pneumatike;
- 5) armët me gaz;

- 6) armët shpërthyes;
- 7) armët me hark ose me tojë;
- 8) armët e ftohta;
- 9) armët e zjarrit për sinjalizim me dritë dhe me zë dhe
- 10) paralizuesit elektrikë.

Dispozitat e këtij ligji për blerjen, posedimin dhe përdorimin e armëve të zjarrit dhe municioneve, zbatohen përkatësisht edhe për pjesët kryesore të armëve të zjarrit dhe municionet për armët e zjarrit, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj; Në kuptimin e këtij ligji nuk janë armë:

- 1) armët dekorative;
- 2) imitimet e armëve;
- 3) armët e zjarrit të çaktivizuara plotësisht;
- 4) armët e zjarrit antike;
- 5) riprodhim i armës së zjarrit antike;
- 6) armët për qëllime industriale dhe
- 7) harpunët për peshkim nën ujë.

Neni 3

Termat e përdorur në këtë ligj përkufizohen si më poshtë:

“Armë zjarri” janë të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave dhe revolverëve, si dhe mjete të tjera që nën presionin e gazeve mund të hedhë nga tyta predha në formë grumbulli saçmash ose plumbi;

“Armë zjarri e shkurtër” është arma e zjarrit me tytë jo më të gjatë se 30 centimetra apo me gjatësi të përgjithshme jo më shumë se 60 centimetra;

“Armë zjarri e gjatë” është arma e zjarrit me tytë më të gjatë se 30 centimetra apo me gjatësi të përgjithshme më shumë se 60 centimetra;

“Armë zjarri automatike” është arma e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepet fisheku dhe që mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

“Armë zjarri gjysmautomatike” është arma e zjarrit që rimbushet në mënyrë automatike sa herë që shkrepet fisheku dhe që mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

“Armë zjarri me mbushje mekanike” është arma e zjarrit e cila, pas shkrepjes së plumbit rimbushet dhe zbrazet me dorë, me vendosjen e fishekut në tytë, i cili merret nga karikatori dhe përcillet me ndihmë të mekanizmit. “Armë zjarri me një qitje” është arma e zjarrit pa karikator, e cila mbushet para çdo shkrepjeje, përmes futjes me dorë të fishekut në fole dhe në hapjen për mbushje

në të prerën e tytës;

“Armë Pneumatike” janë të gjitha llojet e pushkëve, pistoletave, revolverëve dhe mjete të tjera të cilat nën presionin e ajrit apo gazeve të kompresuar, shkrepin predha me formë të ndryshme;

“Armë me gaz” janë të gjitha llojet e pistoletave, revolverëve dhe mjeteve të tjera që nën shtypjen e barutit ose të gazeve përhapin ose shpërndajnë gaz ngacmues që ka ndikim afatshkurtër në shëndetin e njeriut;

Si armë me gaz, në kuptimin e këtij ligji, nuk konsiderohen pajisjet që përhapin ose shpërndajnë gaz ngacmues që ka ndikim afatshkurtër në shëndetin e njeriut, dhe janë të projektuara veçanërisht për vetëmbrojtje;

“Armë zjarri për sinjalizim me dritë dhe me zë” janë të gjitha llojet e pistoletave, revolverëve dhe pajisjeve të tjera që nën shtypjen e barutit ose të gazeve shkrepin ose hedhin të shtëna sinjalizuese në një drejtim dhe lëshojnë predha ose shkaktojnë sinjalizim akustik;

“Armë shpërthyesë” janë të gjitha llojet e bombave, minave, raketave, granatave apo pajisjeve të tjera që përmbajnë lëndë plasëse apo materiale të ndezshme ndaj të cilave, për shkak të proceseve të brendshme apo të jashtme (peshës, goditjes, fërkimit, reagimit kimik, energjisë elektrike dhe të ngjashme), shkaktohet çlirimi apo krijimi i energjisë dhe shpërthimit.

Në kuptimin e këtij ligji, pjesët e eksplozivëve, detonatorët dhe objekte të tjera, për të cilat qartazi duket se janë të përcaktuara për përgatitjen e armëve shpërthyesë, do të konsiderohen armë shpërthyesë.

“Armë me hark ose me tojë” janë harqet dhe mekanizmat e tjerë që nën shtypjen e tojës së shtrënguar të harkut, gjuajnë me shigjetë apo predhë tjetër;

“Armë e ftohtë” janë të gjitha llojet e objekteve të përgatitura për sulm ose për të shkaktuar lëndim trupor, me përdorimin e forcës fizike të sulmuesit, si dhe objekte të tjera të përshtatshme për të shkaktuar lëndime trupore kur ato mbahen në mbledhje publike, lokale dhe vende të tjera të ngjashme;

“Paralizuesit elektrikë” janë pajisje të krijuara për sulm ose mbrojtje, të cilat nën ndikimin e elektricitetit apo presionit të lartë, shkaktojnë shok elektrik, që paralizon personin ndaj të cilit përdoret.

“Armë për qëllime industriale” është arma e prodhuar për përdorim industrial ose teknik, me kusht që të përdoret vetëm për këto qëllime;

“Armë zjarri për gjueti” është armë zjarri e kategorisë B dhe C, me të cilën lejohet gjuetia në përputhje me rregulloret për gjueti.

“Armë zjarri sportive” është armë zjarri e kategorisë B dhe C, armë pneumatike dhe armë me hark e cila në përputhje me rregulloret të veçanta përdoret në disiplinat sportive;

“Armë e koleksionit” është armë origjinale e kategorisë B dhe C, e cila është prodhuar në periudhën 1898 dhe 1945 dhe lidhet me një ngjarje të rëndësishme historike;

“Armë për vetëmbrojtje” është armë zjarri me një qitje, gjysmautomatike ose armë zjarri me përsëritje e kategorisë B dhe C, me kalibër më të madh se 5,6 milimetra, që shërben për mbrojtjen e jetës së mbajtësit të armës dhe për sigurimin e personit dhe të pronës;

“Armë antike” janë armët e ftohta dhe armët e zjarrit që përdornin barut të zi, të prodhuara para vitit 1898 dhe që kanë vlerë historike, antike ose artistike, të cilat nuk janë më në përdorim dhe për të cilat është lëshuar vërtetim nga Muzeu Kombëtar i Maqedonisë në Shkup;

“Riprodhim i armës së zjarrit antike” është imitimi i armës antike (armë zjarri e gjatë ose e shkurtër), e cila mbushet me barut të zi nga goja e tytës së armës dhe ndizet me fitil, gurë ose kapsulë;

“Pjesë kryesore të armës së zjarrit” janë mekanizmat për mbylljen (shuli), foleja e fishekëve dhe tyta e të gjitha llojeve të armëve;

“Pajisje e posaçme për armë zjarri” është çdo mekanizëm, që është i prodhuar dhe i dedikuar për përmirësimin e konstruksionit bazë të armës së zjarrit, duke rritur kështu performancën dhe cilësinë e përdorimit të armës, përveç shënjestrës optike.

“Shënjestra optike” është pajisje e posaçme për armë, e cila përdoret për të përmirësuar armët e gjuetisë dhe ato sportive për qëllime përkatëse të autorizuara, e cila blihet dhe posedohet nga personi fizik që është anëtar aktiv i shoqatës së gjuetarëve ose të gjuajtësve me hark;

“Armë dekorative” janë objektet që prodhohen për qëllime dekorative dhe që nuk mund të përdoren si armë zjarri;

“Armë zjarri e paaftësuar plotësisht (çaktivizuar)” është armë e kategorisë B, C dhe D, e cila ka humbur plotësisht karakteristikat e armës, përmes zbatimit të procedurës teknike në njërin nga pjesët kryesore të armës së zjarrit, e cila nuk është më në gjendje për t’u hequr, zëvendësuar apo riparuar, dhe me të cilën arma është çaktivizuar plotësisht për përdorim të mëtejshëm;

“Armë zjarri e çaktivizuar pjesërisht” është armë zjarri e kategorisë B, C dhe D, e cila

përmes zbatimit të procedurës teknike në njërin nga pjesët kryesore të armës së zjarrit është çaktivizuar pjesërisht;

“Imitim arme” janë objektet, dukja e jashtme e të cilëve ngjason me atë të armës, por që nuk mund të përdoren si armë zjarri;

“Municion” janë të gjitha llojet e gëzhjojave, plumbave dhe predhave të prodhuara për mbushjen dhe funksionimin e armës;

“Municion i vërtetë” janë të gjitha llojet e plumbave, që mbushen me predha dhe që kanë fuqi për të vrarë;

“Municion me plumb blindshpues” është municioni i përgatitur për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit është i përbërë nga bërthamë e fortë, dhe ka fuqi depërtuese;

“Municioni me predhë eksplozive” është municioni i prodhuar vetëm për përdorim ushtarak, plumbi i të cilit përmban mbushje që shpërthen;

“Municioni me plumba të ndezshëm” është municioni i prodhuar vetëm për përdorim ushtarak, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike të ndezshme;

“Municioni manovre” është municioni që përmban mbushje shtytëse dhe plumba që nuk kanë predha;

“Municioni që shkakton trullasje dhe gjendje gjumi” është municioni i prodhuar për kryerjen e aktiviteteve humane, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike, që shkakton gjumë të parakohshëm dhe paaftësim dhe

“Municioni gjurmëlënës” është municioni i prodhuar vetëm për përdorim ushtarak, plumbat e të cilit përmbajnë përzierje kimike, që me djegien lë gjurmë gjatë trajektorës së lëvizjes së predhës;

“Municioni për armët e gazit” është municioni që përmban mbushje kimike me gaz ngacmues, që ka efekt afatshkurtër në shëndetin e njerëzve dhe

“Adaptues” janë pajisje të prodhuara për përdorim gjatë gjuetisë ose gjuajtjeve me hark, të cilat futen në tytën e armës për arsye të ndryshimit të llojit dhe kalibrit të armës, me të cilën arma nuk e ndryshon kategorinë ekzistuese, në përputhje me këtë ligj.

II. BLERJA DHE POSEDIMI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 4

Armët, në kuptimin e këtij ligji kategorizohen në kategoritë e mëposhtme:

Kategoria A – armë, blerja e të cilave është e ndaluar:

- 1) predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lëshim;
- 2) armët e zjarrit automatike;
- 3) armët e zjarrit të kamufluara në formën e një objekti tjetër
- 4) municioni me plumb blindshpues, municioni me predhë eksplozive, municioni me predha të ndezshme, si dhe predhat për municione të tilla;
- 5) municioni për pistoleta dhe revolverë me predhë me efekt shpërndarës, si dhe predhat për municione të tilla, përveç municioneve për armët për gjueti apo ato sportive;
- 6) armët e zjarrit me silenciator të integruar;
- 7) armët e zjarrit me tytë të vjaskuar me kalibër mbi 12,7 milimetra;
- 8) armët shpërthyese dhe pjesët e tyre;
- 9) armët me gaz dhe municioni për armët me gaz
- 10) pajisjet e veçanta për armët e zjarrit;
- 11) paralizuesit elektrikë dhe
- 12) municioni gjurmëlënës.

Në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni, armët e zjarrit për gjueti dhe ato sportive të pajisura me shënjestër optike nuk do të konsiderohen armë zjarri të ndaluara.

Kategoria B – armë që mund të blihen mbi bazën e një autorizimi:

- 1) armët e shkurtra të zjarrit gjysmautomatike apo vetëmbushëse;
- 2) armët e zjarrit të shkurtra me një qitje, me ndezje qendrore;
- 3) armët e zjarrit të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme më të vogël se 28cm;
- 4) armët e gjata të zjarrit gjysmautomatike, me gushë ose fole që mund të pranojnë më tepër se tre fishekë;
- 5) armët e gjata të zjarrit gjysmautomatike, me gushë ose fole që mund të pranojnë deri në tre fishekë, ku mbushësi i tyre ndërrohet. Këto armë mund të konvertohen, me ndihmën e një mjeti të zakonshëm, dhe gusha ose foleja për fishekët mund të pranojnë më tepër se tre fishekë;
- 6) armët e gjata të zjarrit gjysmautomatike ose me përsëritje, me tytë të pavjaskuar, të gjatë deri në 60 centimetra dhe
- 7) armët e gjata të zjarrit gjysmautomatike, për përdorim civil, që ngjajnë me armët e zjarrit automatike.

Kategoria C – armë që mund të blihet mbi bazën e një autorizimi të lëshuar në kushte lehtësuese:

- 1) armë zjarri e gjatë me përsëritje, që nuk është përfshirë në pikën 6 të kategorisë B;
- 2) armë zjarri e gjatë me një qitje me tytë të vjaskuar;
- 3) armë zjarri e gjatë gjysmautomatike, që nuk është përfshirë në pikat 4, 5, 6 dhe 7 të kategorisë B;
- 4) armë zjarri e shkurtër me një qitje me goditje anësore, gjatësia e përgjithshme e së cilës është e barabartë ose më e madhe se 28 centimetra;
- 5) armë zjarri e gjatë me një qitje, me tytë të pavjaskuar dhe
- 6) adaptues.

Kategoria D – armë që duhet të regjistrohen dhe për të cilat lëshohet autorizim:

- 1) armë zjarri pneumatike;
- 2) armët me hark;
- 3) armët e ftohta, dhe
- 4) armët për sinjalizim me dritë dhe me zë.

Neni 5

Armët dhe municionet mund të blihen vetëm mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, në përputhje me kategorizimin e armëve të përmendur në nenin 4 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe në këtë ligj.

Neni 6

Ministria e Punëve të Brendshme përcakton me detaje llojet e armëve që mund të blihen mbi bazën e një autorizimi dhe kuptimin e llojeve të caktuara të armëve të kategorisë A dhe D, në përputhje me kategorizimin e armëve të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 7

Armët e kategorisë B dhe C të këtij ligji mund blihen mbi bazën e një autorizimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sipas vendbanimit të personit, ose vendqëndrimit të personit të huaj në Republikën e Maqedonisë, apo sipas selisë së personit juridik, që paraqet kërkesën (në vijim referuar si: organi përgjegjës).

Pjesët kryesore të armës mund të blihen mbi bazën e një autorizimi ose certifikate për armët e deklaruara të kategorisë D dhe kjo sipas llojit të armës për të cilën është lëshuar autorizimi për posedim arme ose vërtetimi për deklarimin e armës së kategorisë D.

Municioni për armë me tytë të vjaskuar blihet mbi bazën e një autorizimi për blerjen e municioneve ose mbi bazën e certifikatës për deklarimin e armës të kategorisë D të lëshuar për

atë armë.

Municioni për armët me tytë të pavjaskuar blihet mbi bazën e autorizimit të lëshuar për atë armë.

Autorizimi për blerjen e armëve, autorizimi për blerjen e pjesëve të armëve dhe autorizimi për blerjen e municioneve është i vlefshëm gjashtë muaj nga dita e lëshimit të tij.

Personi fizik mund të blejë dhe të posedojë municion për armët me tytë të vjaskuar deri në të paktën 200 plumba gjatë një viti kalendarik, vetëm nëse vërteton se ekzistojnë arsye të justifikuara për blerjen dhe posedimin e një sasive më të madhe municioni nga ajo që është përcaktuar për një vit kalendarik, p.sh. nëse vërteton se merr pjesë në gjueti, qitje sportive etj.

Personi fizik mund të blejë dhe të posedojë municion për armët me tytë të pavjaskuar dhe armët pneumatike pa kufizim të sasisë së municionit.

Personi juridik, që regjistrohet për kryerjen e sigurimit të personit dhe pronës ose që kryejnë aktivitetin e sigurimit të personit dhe pronës për nevojat e tyre personale, mund të posedojnë municion për armët deri në 50 plumba për çdo armë të shënuar në autorizimin për posedim arme.

Neni 8

Autorizimi për blerje arme mund t'u lëshohet personave fizikë për mbrojtjen e tyre dhe të pronës, për gjueti ose qitje sportive.

Autorizimi për të blerë pjesë për armët dhe autorizimi për blerje municioni lëshohen për personat fizikë ose juridikë që posedojnë leje të vlefshme për armë ose leje për posedim arme.

Personat juridikë të regjistruar për kryerjen e sigurimit të personave dhe pronës ose për kryerjen e funksionit të sigurimit të personave dhe pronës për nevoja personale mund të blejnë armë në bazë të një autorizimi, për qëllimin e mbrojtjes së personave dhe pronës ose për kryerjen e funksionit të sigurimit të personave dhe pronës.

Autorizimi për blerjen e armëve sportive dhe të gjuetisë mund të lëshohet edhe për shoqatat e qitësve ose të gjuetarëve, si dhe për personat juridikë të cilët ushtrojnë gjuetinë në terren.

Autorizimi për blerjen e armëve të zjarrit dhe atyre pneumatike me municion që përmban substanca trullësuese ose përgjumëse për paralizimin e përkohshëm të kafshëve mund të lëshohet për institucione shkencore, organe shtetërore dhe persona të tjerë juridikë për kërkime shkencore dhe mbledhjen e të dhënave për llojet e kafshëve, mbrojtjen e kafshëve, si dhe në raste të tjera të justifikuara që përfshihen në aktivitetin e tyre të përditshëm, dhe që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

Neni 9

Autorizimi për të blerë armë u jepet personave fizikë mbi bazën e kërkesës së paraqitur më parë me shkrim për lëshimin e autorizimit për blerje arme, me kusht që personi fizik të plotësojë kushtet në vijim:

- 1) ka mbushur 18 vjeç;
- 2) nuk i është hequr apo kufizuar aftësia për të vepruar;
- 3) është në gjendje shëndetësore të posedojë dhe të mbajë armë;
- 4) nuk përfaqëson rrezik për rendin publik;
- 5) ka arsye të vlefshme për blerje armë;
- 6) ka njohuri teknike për përdorimin e drejtë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e armës dhe njohuri të rregulloreve për armët dhe
- 7) banon në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe nëse është i huaj, të ketë leje qëndrimi të përhershme në territorin e Republikës së Maqedonisë, me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe nga marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare.

Autorizimi për blerje armësh të kategorisë C lëshohet për personat fizikë që përveç kushteve të paragrafit 1 pikat 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 të këtij ligji, është e nevojshme të jetë anëtar aktiv i një shoqate të qitësve ose gjuetarëve, dhe të ketë certifikatën për kalimin e testit të gjuetisë, apo certifikatën se është anëtar aktiv i shoqatës së harkëtarëve.

Neni 10

Me anë të një certifikate të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale dhe mbi bazën e një vendimi gjykate, personi fizik vërtetohet se nuk i është hequr apo kufizuar aftësia për të vepruar sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji.

Certifikata e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të jetë më i vjetër se një vit.

Neni 11

Aftësia shëndetësore për posedimin dhe mbajtjen e armës sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 3 të këtij ligji, vërtetohet me vizitë mjekësore dhe vërtetohet me raport mjekësor.

Raporti mjekësor i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk mund të jetë më i vjetër se një vit.

Shpenzimet për vizitat mjekësore i mbulon personi fizik.

Ministri i Shëndetësisë së bashku me Ministrin e Punëve të Brendshme do të përcaktojë llojin dhe mënyrën e kryerjes së vizitës mjekësore për vërtetimin e aftësisë shëndetësore për posedimin dhe mbajtjen e armës, listën e sëmundjeve dhe gjendjen shëndetësore që e bëjnë personin të paaftë për të mbajtur armë, si dhe mënyrën e procedurës së nxjerrjes së raportit mjekësor.

Vizitat mjekësore të personit fizik për vërtetimin e aftësisë shëndetësore për posedim dhe mbajtje arme kryhen në institucionet shëndetësore që përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë së bashku me Ministrin e Punëve të Brendshme.

Neni 12

Konsiderohet se ekziston rrezik për rendin publik sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 4 të këtij ligji, nëse:

- personi fizik është dënuar për vepër penale të kryer me paramendim në krye të detyrës,
- personi fizik është dënuar për shkelje të rendit dhe paqes publike duke përdorur elementë të dhunës dhe
- ekzistojnë rrethana të tjera që vërtetojnë se arma mund të keqpërdoret, e sidomos kur personi është i regjistruar në regjistrat e organeve përgjegjëse për konsumim të shpeshtë dhe të tepruar të alkoolit ose përdorimin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; prishje të marrëdhënieve familjare, në institucione arsimore ose në vendin e punës etj.

Nëse ndaj personit fizik është ngritur një proces për vepër penale, ose për kundërvajtje sipas paragrafit 1 pika 1 dhe 2 të këtij neni, dhe personi i plotëson kriteret e tjera për lëshimin e autorizimit për blerje armësh, organi përgjegjës do të ndërpresë procedurën për lëshimin e autorizimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar për procedurën penale apo shkeljen.

Neni 13

Personi fizik ka arsye të justifikuara për blerjen e armës sipas nenit 9 paragrafi 1 pika 5 të këtij ligji, nëse vërtetohet se ekzistojnë arsye të justifikuara për posedimin e armës, dhe nëse siguria e tij personale, siguria e familjes së tij ose pronës janë seriozisht të rrezikuara, për të cilat është e nevojshme posedimi i armës për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre ose nëse punët dhe detyrat që kryen në vendin e punës janë të kësaj natyre që mund të shkaktojnë rrezik për jetën dhe pronën.

Përveç arsyeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohet se personi fizik vërtetohet se ka arsye të justifikuara për posedimin e armës, nëse:

- është anëtar aktiv në një shoqatë të qitësve ose të gjuetarëve dhe ka vërtetim për marrjen e provimit profesional, apo vërtetim se është anëtar i një shoqate harkëtarësh,
- koleksionon armë, apo është koleksionist,
- me vendim gjykate të prerë trashëgon armën,
- si çmim është dhënë një armë për rezultatet e arritura në konkurse zyrtare në gjueti ose qitje sportive ose
- si çmim dhënë një armë nga ana e organeve shtetërore, organizatave ndërkombëtare ose organeve shtetërore të shteteve të tjera.

Neni 14

Kontrolli i njohurive teknike për përdorimin e duhur, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e armës dhe njohurive mbi rregulloret për armët (neni 9 paragrafi 1 pika 6) realizohet me dhënien e provimit profesional para komisionit të formuar nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Provimi profesional përbëhet nga dy pjesë, pjesa teorike dhe praktike.

Nëpërmjet pjesës teorike të provimit konfirmohen njohuritë për:

- rregulloret nga fusha e posedimit, ruajtjes dhe mbajtjes së armëve dhe municioneve dhe rregulloret lidhur me të drejtën e përdorimit të armës,
- armët dhe municionet dhe
- dhënien e ndihmës së parë. Pjesa praktike e provimit përmban:
- kontrollin e njohurive për përdorimin e sigurt të armës dhe municioneve dhe
- qitjen në shenjë dhe vlerësimin e rezultateve.

Aftësimin praktik për përdorimin e armës të personave fizikë, të cilët kërkojnë të pajisen me autorizim për blerje arme e realizon personi juridik i autorizuar, për të cilin është i detyruar të lëshojë një certifikatë të posaçme.

Aftësimin praktik të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni, e realizojnë lektorë dhe instruktorë, që kanë përfunduar arsimin e lartë (Bachelor), si dhe ndihmës instruktorë që kanë përfunduar të paktën arsimin e mesëm.

Instruktorët dhe ndihmësit e tyre të përmendur në paragrafin 6 të këtij neni duhet të plotësojnë kushtet e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 të këtij ligji.

Autorizimin e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni e lëshon personi juridik i cili ka marrë autorizim për hapjen e poligonit civil të qitjes.

Ministri i Punëve të Brendshme miraton rregulloren e detajuar për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet për aftësimin praktik të përdorimit të armës të personave juridikë të përmendur në paragrafin 5 të këtij neni.

Shpenzimet për aftësimin praktik dhe ato për kryerjen e provimit i mbulon personi i cili kërkon të pajiset me autorizim për blerje arme.

Dispozitat e paragrafit 5 të këtij neni nuk i referohen personelit ushtarak dhe civil që shërben në Forcat e Armatosura, policisë, punonjësve të shërbimit të sigurisë në institucionet penitenciare dhe punonjësve të tjerë të organeve shtetërore që me rregullore të veçanta janë të autorizuar të mbajnë këto lloj armësh.

Ministri i Punëve të Brendshme miraton programin e trajnimit për përdorimin e duhur, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e armës, mënyrën e kryerjes së aftësimin praktik për përdorimin e armës, si dhe mënyrën e realizimit të provimit profesional për kontrollin e njohurive teknike për përdorimin e duhur të armës dhe njohurive të rregulloreve për armët.

Neni 15

Njohuritë teknike për përdorimin e duhur të armës dhe njohuritë e rregulloreve për armët vërtetohen edhe me anë të një autorizimi të vlefshëm për këto lloj armësh.

Në përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, njohuritë teknike për përdorimin e duhur të armës dhe njohuritë e rregulloreve për armët vërtetohen me anë të autorizimit për armë, e cila

është anuluar sipas nenit 41 paragrafi 1 pika 5 e këtij ligji.

Personeli që shërben në Forcat e Armatosura, polici, shërbimin e sigurisë së institucioneve penitenciare dhe punonjës të tjerë të organeve shtetërore që me rregullore të veçanta janë të autorizuar të mbajnë armë, vërteton se i plotëson kriteret e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 pikat 2, 3 dhe 6 të këtij ligji me një certifikatë të lëshuar nga organi përgjegjës përkatës se janë të autorizuar të mbajnë armë.

Personat që kryejnë funksionin e sigurimit të personit dhe pronës, vërtetojnë se i plotësojnë kriteret e përmendura në nenin 9 paragrafi 1 pikat 3 dhe 6 të këtij ligji me anë të një licence për kryerjen e funksionit të mbrojtjes së personit dhe pronës.

Neni 16

Leja për blerje arme i lëshohet personit juridik mbi bazën e një kërkesë të paraqitur paraprakisht për marrjen e lejes për blerje arme, nëse personi juridik ka:

- 1) arsye të justifikuar për blerjen e armës për sigurimin e personit dhe të pronës dhe
- 2) ambient të përshtatshëm për vendosjen dhe ruajtjen e armës.

Personat juridikë që blejnë armë për arsye të mbrojtjes së personit dhe pronës ose që kryejnë funksionin e mbrojtjes së personit dhe pronës, përveç kushteve të paragrafit 1 të këtij neni është e nevojshme të kenë edhe punonjës që janë në marrëdhënie pune me kohë të plotë dhe që plotësojnë kushtet e nenit 9 paragrafi 1 pika 4 dhe 6 të këtij ligji.

Neni 17

Aplikanti ka të drejtën e ankimimit pranë komisionit përgjegjës të qeverisë së Republikës së Maqedonisë (në vijim referuar si: Komisioni) kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e lejes për blerje arme, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 18

Personi fizik ose juridik të cilit i është lëshuar autorizimi për blerje arme, është i detyruar që brenda tetë ditëve nga dita e realizimit të blerjes së armës të paraqesë pranë organit përgjegjës kërkesën për regjistrimin e armës dhe për lëshimin e lejes për armën ose të autorizimit për posedim arme, si për personat juridikë dhe fizikë përkatësisht.

Shoqëritë tregtare që kryejnë tregti armësh kanë për detyrë që brenda pesë ditëve nga dita e realizimit të blerjes së armës të paraqesin njoftim pranë organit përgjegjës me të dhënat për personin fizik apo juridik që ka blerë armën dhe të dhënat për armën me qëllim realizimin e qitjeve provë.

Neni 18-a

Qitjet provë të përmendura në nenin 18 paragrafi 2, nenin 35 paragrafi 3 dhe nenin 86 paragrafi 3 të këtij ligji, do të realizohen nga komisionet e organit përgjegjës.

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë aktin nënligjor për përbërjen e komisioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, për mënyrën e realizimit të qitjeve provë, si dhe për ruajtjen e gëzhgojave nga armët e përdorura për qitjet provë.

Neni 19

Për armët e blera me leje, personit fizik i lëshohet autorizim për armën, ndërsa personit juridik autorizim për posedim arme.

Për armët e gjuetisë dhe ato sportive mund të lëshohet autorizim për armë për maksimumi tre persona (bashkëpërdorues të armës), që janë pjesëtar të së njëjtës familje.

Neni 20

Organi përgjegjës refuzon të lëshojë autorizim për armë, apo autorizim për posedim arme,

nëse për armën nuk mund të vërtetohet origjina e saj, nëse nuk është markuar sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ose kur gjatë procesit të regjistrimit do të rezultojnë arsye për refuzimin e kërkesës për regjistrimin e armës.

Në rastet e paragrafit 1 të këtij neni do të sekuestrohet arma dhe autorizimi për blerje arme, ndërsa me armën do të veprohet sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 21

Autorizimi për armë lëshohet me një afat vlefshmërie deri në dhjetë vjet, ndërsa për personat mbi moshën 65 vjeç me afat vlefshmërie deri në pesë vjet.

Afati i autorizimit për armë rinovohet përmes një kërkesë me shkrim të mbajtësit të saj, e cila dorëzohet pranë organit përgjegjës jo më vonë se dy muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tij.

Kushtet për rinovimin e autorizimit të përmendur në nenin 12 të këtij ligji përcaktohen ex officio nga organi përgjegjës, ndërsa nëse personi është mbi moshën 65 vjeç, është e nevojshme të dorëzohet edhe raport mjekësor jo më të vjetër se një vit sipas nenit 11 të këtij ligji.

Për personin që ka njoftuar se për arsye të moshës, sëmundjes, etj nuk e ka të nevojshme përdorimin e mëtejshëm të armës, organi përgjegjës zëvendëson autorizimin për armë dhe autorizimin për posedim arme në përputhje me ligjin “Për blerjen, posedimin dhe mbajtjen e armëve” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 26/76, 15/83, 51/88 dhe

“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003) me një certifikatë për posedim arme, me të cilën arma nuk mund të përdoret më.

Përveç rasteve të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni, certifikata për posedim arme lëshohet për personin të cilit i është lëshuar certifikatë për çaktivizim të përkohshëm të armës, në përputhje me nenin 39 paragrafi 6 të këtij ligji.

Neni 22

Autorizimi për posedim arme i lëshohet një personi juridik me afat përdorimi deri në dhjetë vjet.

Afati i autorizimit për posedim arme rinovohet përmes një kërkesë me shkrim të personit juridik, e cila dorëzohet pranë organit përgjegjës jo më vonë se dy muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tij.

Bashkangjitur kërkesës për rinovimin e afatit të autorizimit për posedim arme, personi juridik duhet të paraqesë prova se i plotëson kushtet e nenit 16 paragrafi 1 të këtij ligji.

Neni 23

Personat juridikë që posedojnë armë në bazë të autorizimit për posedim arme, lejojnë vetëm punonjësit e punësuar rregullisht pranë tyre që ta përdorin këtë armë, të cilët kryejnë funksionin e ruajtjes së personave dhe pronës, dhe që plotësojnë kushtet e nenit 9 të këtij ligji.

Me kërkesë të personit juridik të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, organi përgjegjës i lëshon përdoruesit të armës autorizim për mbajtje arme, me afat vlefshmërie deri në dhjetë vjet.

Afati i vlefshmërisë së autorizimit për mbajtje arme mund të rinovohet, me kërkesë të personit juridik, nëse personi për të cilin është lëshuar autorizimi i plotëson ende kushtet e nenit 9 të këtij ligji. Kërkesën për rinovimin e autorizimit për mbajtje arme personi juridik e dorëzon jo më vonë se dy muaj përpara përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tij.

Punonjësi të cilit i ka përfunduar marrëdhënia e punës me personin juridik të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në ditën e përfundimit të marrëdhënies të punës është i detyruar që armën dhe autorizimin për mbajtjen e armës t’ia dorëzojë personit përgjegjës të personit juridik.

Personi juridik i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni është i detyruar që brenda tetë ditëve nga përfundimi i marrëdhënieve të punës, të njoftojë me shkrim organin përgjegjës për punonjësën të cilit i ka përfunduar marrëdhënien e punës, dhe në emrin e të cilit është lëshuar autorizimi për mbajtje arme. Organi përgjegjës bën shfuqizimin e menjëhershëm të autorizimit për mbajtje arme.

Neni 24

Personat fizikë të përmendur në nenin 23 të këtij ligji e mbajnë armën vetëm gjatë kohës së kryerjes së funksionit dhe detyrës së mbrojtjes së personave dhe pronës.

Neni 25

Përdoruesit e zonave të gjuetisë mund t'ia besojnë armën e gjuetisë për të cilën disponojnë autorizim një anëtar i aktiv të shoqatës së gjuetarëve që disponon autorizim për këtë lloj arme, për gjueti njëditore në atë zonë gjuetie, duke lëshuar dhe një certifikatë për këtë.

Neni 26

Shoqatat e qitjes mund t'ia japin për përdorim armët dhe municionet për të cilat disponojnë autorizim vetëm anëtarëve të tyre aktivë gjatë kohës kur ushtrojnë ose konkurrojnë në qitje ose në një terren të caktuar për këtë qëllim.

Nëse magazina e armëve e shoqatës së qitjes nuk është në vendin e qitjes apo në terrenin e caktuar për këtë qëllim, anëtarët e shoqatës së qitjes duhet të kenë certifikatë për transferimin e armëve në ato vende dhe anasjelltas, i cili lëshohet nga shoqata e qitjes, me vlefshmëri deri në përfundim të ushtrimit apo konkursit.

Neni 26-a

Miratimi për blerje të armëve të koleksionit për personat fizikë lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të dorëzuar paraprakisht për marrjen e lejes për blerje të armëve të koleksionit, me kusht që personi fizik të plotësojë kushtet e nenit 9 dhe 33 të këtij ligji dhe të dorëzojë certifikatën e lëshuar nga ana e Muzeut Kombëtar të Maqedonisë në Shkup.

Nëse koleksioni i armëve të koleksionit përbëhet nga mbi 25 copë, përveç kërkesës së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personi fizik (koleksionisti) duhet të dorëzojë një miratim me shkrim për mbikëqyrjen nga organi përgjegjës të mënyrës së ruajtjes dhe mbajtjes së armëve.

Personi fizik (koleksionisti) të cilit i është lëshuar miratimi për blerje të armëve të koleksionit, ka për detyrë që brenda tetë ditëve nga dita e realizimit të blerjes së armës të dorëzojë një kërkesë për regjistrimin e armës dhe lëshimin e lejes për armën e koleksionit pranë organit përgjegjës.

Leja e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni është e vlefshme për dhjetë vjet.

Pas lëshimit të lejes së përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, miratimi për blerje të një arme tjetër koleksioni lëshohet vetëm nëse personi fizik (koleksionisti) plotëson kërkesën e parashikuar në nenin 9 paragrafi 1 pika 4 të këtij ligji.

Neni 27

Armët e kategorisë D mund të blihen nga personi fizik që plotëson kërkesën e nenit 9 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji, nga shoqatat e qitësve dhe të gjuetarëve, persona juridikë që janë përdorues të terrenit për gjueti, si dhe nga institucionet shkencore, organet shtetërore dhe persona të tjerë juridikë për arsye të kryerjes së funksioneve në kuadër të aktivitetit të tyre të përditshëm dhe që lidhen me mbrojtjen e personave, kafshëve ose të mjedisit.

Personi fizik ose juridik që ka blerë armë sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka për detyrë që brenda tetë ditëve nga dita e realizimit të blerjes së armës të regjistrojë armën pranë organit

përgjegjës, për të cilën lëshohet një certifikatë.

Neni 27-a

Muzeu Kombëtar i Maqedonisë në Shkup lëshon certifikatë për armët antike.

III. MËNYRA E PËRDORIMIT TË ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 28

Zotëruesi ose përdoruesi i armës ka për detyrë që armën ta mirëmbajë në gjendje të mirë, ta përdorë atë me kujdes dhe ta ruajë në mënyrë të atillë që të parandalojë aksesin nga persona të paautorizuar.

Personat e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nuk duhet të fshijnë ose të dëmtojnë markimet e stampuara në armë nga ana e prodhuesit të saj ose markimet shtesë të stampuara në armë nga ana e organeve të tjera përgjegjëse.

Neni 29

Është e ndaluar shitja e armëve dhe municioneve të personat që nuk kanë autorizim për blerjen e tyre, apo autorizim për blerje armësh koleksioni, si dhe dhënia e armës për përdorim një personi që nuk ka leje për armë ose leje për armë koleksioni, ose leje për mbajtje të asaj arme.

Neni 30

Është e ndaluar mbajtja e armëve në kuptimin e nenit 24 të këtij ligji, si dhe i imitimeve të armës që nuk ndryshojnë shumë nga arma, në mënyrë të atillë që mund të shqetësojë banorët ose ta bëjë armën qartësisht të dukshme.

Neni 31

Me mbajtje arme, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohen të gjitha mënyrat e mbajtjes së armës e cila është gati për përdorim, nga ana e poseduesit të saj, përveç transportimit të armës.

Zotëruesi ose përdoruesi i armës që ka të drejtë ta mbajë atë, ka për detyrë që ta mbajë armën në mënyrë që mos të rrezikojë sigurinë e tij personale dhe atë të të tjerëve.

Zotëruesi ose përdoruesi i armës e transporton armën, nëse është teknikisht e mundur, të çmontuar, pra me tytën e shkëputur nga mekanizmi i shulit dhe, nëse kjo nuk është e mundur, me municionin e ndarë nga arma.

Është e ndaluar mbajtja dhe përdorimi i armës nga ana e zotëruesit apo përdoruesit të saj, që nën ndikimin e alkoolit, drogës ose në mënyrë tjetër do të gjendet para një situatë që nuk mund të kuptojë veprimet e tij ose t'i kontrollojë ato.

Është e ndaluar mbajtja dhe përdorimi i armëve në vende publike, përveçse për punonjësit që kryejnë funksionin e mbrojtjes së personit dhe pronës në organet shtetërore dhe personat juridikë, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e personit dhe pronës.

Në kuptimin e këtij ligji, vend publik konsiderohet një vend i aksesueshëm pa kushte nga një numër i pacaktuar njerëzish (rrugë, sheshe, vende kampimi, porte, aeroporte, stacione treni, stacione autobusi, vende pritjeje, restorante, qendra tregtare, dyqane artizanale etj) ose nën kushte të caktuara (ambientet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, organeve shtetërore, gjykatave, Prokurorisë Publike, Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë, njërive të qeverisjes lokale, institucioneve arsimore, shëndetësore dhe sociale, stadiumeve sportive, parqeve të lojërave, automjetet e transportit publik, sallat e kinemave, sallat e koncerteve dhe teatrale, ambientet e ekspozitave, kopshtet etj), si dhe vende të tjera që në kohë të caktuar shërbejnë për këtë qëllim (vende ose ambiente ku mbahen tubime publike, aktivitete, konkurse

etj), ku me përdorimin e saj mund të rrezikohet siguria e njerëzve.

Në kuptimin e këtij ligji, vend publik nuk do të konsiderohet vendi që është i dukshëm nga vendi publik (ballkon, terracë, oborr, shtyllë), si dhe mjetet e transportit në pronësi të qytetarëve, vende qitjeje dhe terrene për ushtrime dhe gjueti në sezonin e gjuetisë.

Përveçse në vendet e përmendura në paragrafin 6 të këtij neni futja e armëve është e ndaluar edhe në vende të tjera, ku në hyrjen e të cilave pronari i tyre ka ndaluar dukshëm futjen e armëve në ato vende.

Është e ndaluar që armët e gjuetisë të mbahen dhe të përdoren jashtë vendit të gjuetisë apo të qitjes. Kur ndodhet jashtë terreneve të gjuetisë, zotëruesi ose përdoruesi i armës së gjuetisë ka për detyrë që armën ta transportojë në valixhe të përshtatshme, ku municioni duhet të jetë i ndarë nga arma.

Është e ndaluar që armët e sportit të mbahen dhe të përdoren jashtë vendit të qitjes ose terreneve të tjera të përcaktuara për gara në qitjen sportive. Jashtë vendit të qitjes ose terreneve të tjera të përcaktuara për gara në qitje sportive, zotëruesi ose përdoruesi i armës sportive ka për detyrë që armën sportive ta transportojë në valixhe të përshtatshme, ku municioni duhet të jetë i ndarë nga arma.

Është e ndaluar që armët e koleksionit të mbahen dhe përdoren jashtë vendit të banimit ose të qëndrimit të përhershëm të personit fizik (koleksionisti). Armët e koleksionit mund të transferohen jashtë vendit të banimit ose të qëndrimit të përhershëm të personit fizik, vetëm për arsye të riparimit, ekspozimit ose shitjes së armëve të koleksionit.

Është e ndaluar blerja, posedimi dhe prodhimi i municioneve për armët e koleksionit.

Dispozita e paragrafit 5 të këtij neni nuk zbatohet për pjesëmarrësit në:

1) prodhimin e filmave, shfaqjeve teatrale dhe manifestimeve të tjera kulturore të cilët për nevojat e tyre përdorin armë të pambushura ose armë me municione manovër;

2) garat e qitjes dhe

3) garat sportive, gjatë dhënies së shenjës së nisjes me municion manovër me kërkesë të organizatorit.

Është e ndaluar që armët pneumatike dhe armët me hark të mbahen dhe përdoren jashtë vendit të qitjes ose ambienteve të tjera të siguruara.

Armët sportive, armët pneumatike dhe armët me hark mund të përdoren edhe nga persona minorene vetëm në vendet e qitjes ose ambiente të siguruara të përcaktuara për gara në qitje sportive dhe nën mbikëqyrjen e një personi të rritur.

Neni 32

Personi që mban me vete armë duhet të mbajë me vete dhe autorizimin për armën, apo autorizimin për mbajtjen e armës, të lëshuar në përputhje me këtë ligj.

Me kërkesë të një punonjësi zyrtar të autorizuar të organit përgjegjës, personi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ka për detyrë të tregojë autorizimin për armën, apo autorizimin për mbajtjen e armës.

Neni 33

Koleksionistët që blejnë ose posedojnë armë koleksioni, kanë për detyrë t'i ruajnë ato në një raft të kyçur, në kasafortë ose në ambiente të veçanta që janë teknikisht të siguruara.

Muzetë kanë për detyrë t'i ruajnë armët në ambiente që janë teknikisht të siguruara dhe t'i ekspozojnë ato në mënyrë të atillë që të parandalohet aksesimi dhe vjedhja e armëve.

Neni 34

Personat juridikë të përmendur në nenin 8 paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji kanë për detyrë që armët t'i ruajnë të ndara nga municioni në ambiente që janë teknikisht të siguruara ose në rafte metalike apo kasafortë. Armët dhe municionet, sipas rregullit, ruhen në ambiente të

projektuara për ruajtjen e armëve ose në ambientet ku ndodhet selia e personit juridik.

Personat juridikë kanë për detyrë që për armët dhe municionet të mbajnë regjistra dhe të caktojnë një person përgjegjës në lidhje me to. Për çdo ndryshim personat juridikë kanë për detyrë të njoftojnë organin përgjegjës brenda tetë ditëve nga dita e ndryshimit.

Personi përgjegjës ushtron kontroll për punonjësën zyrtar të autorizuar të autoritetit kompetent për mënyrën e ruajtjes së armëve dhe të mbajtjes së regjistrave të tyre.

Neni 35

Armët mund t'u shiten vetëm personave fizikë apo juridikë që disponojnë autorizim për blerje arme, të lëshuar në bazë të këtij ligji, d.m.th personave juridikë që janë të autorizuar të kryejnë veprimtarinë e tregtimit të armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre.

Shitja e armëve ndërmjet personave fizikë apo juridikë realizohet me kontratë të shkruar, të noterizuar, që përmban: emrin, mbiemrin, datëlindjen, numrin unik personal të shtetasit, numrin e kartës së identitetit ose pasaportës, vendbanimin dhe adresën e banimit të palëve kontraktuale apo të dhënat për personat juridikë; llojin, markën dhe kalibrin e armës; të dhënat për prodhuesin, të dhënat e përmbledhura në leje ose autorizim, si dhe vendin dhe datën e lidhjes së kontratës.

Personat fizikë apo juridikë që blejnë armë në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, kanë për detyrë që brenda tetë ditëve nga dita e lidhjes së kontratës së shitblerjes, të deklarojnë armën e blerë për qitje eksperimentale pranë organit përgjegjës.

Neni 36

Zhdukja, humbja ose vjedhja e armëve dhe municioneve duhet të raportohet nga zotëruesi, përdoruesi apo personi juridik, pranë organit përgjegjës ku është regjistruar arma ose pranë stacionit më të afërt të policisë brenda 24 orëve nga momenti kur e ka vënë re.

Në rastin e zhdukjes, humbjes ose vjedhjes së miratimit për blerje arme, miratimit për blerje arme koleksioni, autorizimit për armë, autorizimit për armë koleksioni, autorizimit për mbajtje arme ose autorizimit për posedim arme, zotëruesi apo personi juridik kanë për detyrë që brenda tetë ditëve ta raportojnë atë pranë organit përgjegjës ku është regjistruar arma ose pranë stacionit më të afërt të policisë dhe të paraqesin kërkesë për lëshimin e kopjeve për këto dokumente.

Neni 37

Armët ose municionet e gjetura dorëzohen menjëherë pranë organit përgjegjës.

Pas përfundimit të afatit tre mujor nga dita e dorëzimit, nëse nuk identifikohet zotëruesi, me armët dhe municionet do të veprohet në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

Neni 38

Në momentin e ndryshimit të vendbanimit ose vendqëndrimit, apo selisë, mbajtësi i autorizimit për armë, autorizimit për armë koleksioni apo autorizimit për posedim arme është i detyruar që brenda 30 ditëve të deklarojë armën pranë organit përgjegjës ku ndodhet vendbanimi, vendqëndrimi apo selia e re.

Neni 39

Në raste vdekjeje të zotëruesit të armës, pjesëtarët në moshë madhore të familjes ose persona të tjerë në moshë madhore që kanë jetuar me të në të njëjtën familje, kanë për detyrë që brenda gjashtë muajve nga vdekja e personit të dorëzojnë:

- Armën pranë shoqërisë tregtare të përmendur në nenin 51-a paragrafi 2 të këtij ligji, të cilët do të kryejnë çaktivizimin e përkohshëm të armës, me vulosje, për të cilën lëshohet certifikatë ose

- Armën dhe municionet pranë organit përgjegjës ose stacionit më të afërt të policisë, për të cilat lëshohet certifikatë.

Personat në moshë madhore të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë që armën e çaktivizuar përkohësisht dhe municionin t'i ruajnë në vendet e tyre të banimit ose qëndrimit, apo në vendin e qëndrimit të përhershëm të autorizuar, deri në përfundimin e procedurës për trashëgiminë.

Ministri i Punëve të Brendshme do të përcaktojë mënyrën e dorëzimit, marrjes në dorëzim dhe ruajtjes së armëve dhe municioneve në rastin e vdekjes së zotëruesit të armës, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës për armët dhe municionet që i dorëzohen organit përgjegjës.

Personi që ka trashëguar armë mundet që brenda dy muajve pas përfundimit të procedurës së trashëgimisë të paraqesë kërkesën për lëshimin e autorizimit për armën ose ta shesë atë në përputhje me nenin 35 të këtij ligji.

Autorizimi për armë i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni lëshohet nëse personi plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 9 paragrafi 1 të këtij ligji.

Nëse personi i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni nuk paraqet kërkesën për lëshimin e autorizimit për armën në afatin e përcaktuar ose kërkesa për autorizim për armën refuzohet, ose personi nuk dëshiron ta shesë armën, atëherë ky person mund të paraqesë kërkesë për çaktivizimin e përkohshëm të armës pranë shoqërive tregtare të përmendura në nenin 51-a paragrafi 2 të këtij neni, për të cilën lëshohet certifikata e përmendur në nenin 51-a paragrafi 3 të këtij ligji.

Nëse personi që nuk jeton më nuk ka trashëgimtarë, me armën do të procedohet në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

Gjykata përgjegjëse për zgjidhjen e trashëgimisë njofton organin përgjegjës për çdo vendim lidhur me trashëgiminë e armës.

Neni 40

Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë njofton organin përgjegjës për përfundimin e aktivitetit të çdo personi juridik që ushtron funksionin e sigurimit të personit dhe pronës.

IV. ANULIMI DHE REVOKIMI I AUTORIZIMIT PËR ARMËN, AUTORIZIMIT PËR ARMËT E KOLEKSIONIT, AUTORIZIMIT PËR POSEDIM ARME DHE AUTORIZIMIT PËR MBAJTJE ARME

Neni 41

Autorizimi për armë, autorizimi për armë koleksioni dhe autorizimi për mbajtje arme do të pezullohet në rastet kur:

- 1) përfundon vlefshmëria e autorizimit dhe ai nuk rinovohet;
- 2) është marrë vendim përfundimtar për revokimin e autorizimit për armë, autorizimit për armë koleksioni apo autorizimit për mbajtje arme;
- 3) leja e qëndrimit të përhershëm të shtetasit të huaj në territorin e Republikës së Maqedonisë ka përfunduar në përputhje me rregulloret për lëvizjen dhe qëndrimin e shtetasve të huaj;

4) ndërrohet mbajtësi i autorizimit, dhe

5) arma është vjedhur apo ka humbur ose është shitur.

Autorizimi për posedim arme do të revokohet në rastet kur:

1) përfundon vlefshmëria e autorizimit dhe ai nuk rinovohet;

2) është marrë vendim përfundimtar për revokimin e autorizimit për posedim arme dhe

3) personi juridik ka pushuar së ekzistuari.

Neni 42

Organi përgjegjës do të marrë vendimin për revokimin e autorizimit për armë, autorizimit për armët e koleksionit apo autorizimit për mbajtje arme kur konstatohet se personi:

- 1) ka humbur aftësinë për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit;
- 2) ka humbur aftësinë për të poseduar ose mbajtur armë, në përputhje me vendimin e institucionit shëndetësor përkatës;
- 3) me vendim gjykate të prerë është dënuar për shkelje ligjore ose kundërvajtje të parashikuara në nenin 12 paragrafi 1 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, dhe
- 4) nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Organi përgjegjës do të marrë vendimin për revokimin e autorizimit për posedim arme kur konstatohet se:

- 1) arsyet për lëshimin e autorizimit nuk ekzistojnë më, dhe
- 2) personi juridik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

Organi përgjegjës do të marrë vendimin për revokim të autorizimit, armëve dhe municioneve nëse gjatë procedurës së zgjatjes së vlefshmërisë së autorizimit për armë do të konstatojë se arma është aq e vjetruar sa me përdorimin e saj mund të rrezikojë sigurinë e njerëzve, ndërsa nuk ekziston mundësi që ajo të rregullohet ose zotëruesi i armës do të vlerësojë se riparimi është ekonomikisht i pajustificuar.

Kundër vendimit të përmendur në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të paraqitet ankesë pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Ankesa kundër vendimit të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk e shtyn afatin e zbatimit të tij.

Në rastet kur autorizimi për armë, autorizimi për armë koleksioni ose autorizimi për posedim arme do të revokohet në përputhje me paragrafin 1 pika 4 dhe paragrafin 2 pika 2 të këtij neni, mund të paraqitet një kërkesë e re për lëshim miratimi për blerje arme, apo një kërkesë e re për lëshimin e miratimit për blerje arme koleksioni brenda pesë viteve nga dita e marrjes së vendimit përfundimtar.

Pas marrjes së vendimit përfundimtar të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, organi përgjegjës e heq armën nga regjistri dhe e shkatërron përmes një procedure të monitoruar nga komisioni, ndërsa për shkatërrimin e saj zotëruesi i armës nuk kompensohet.

Neni 43

Nëse kundër mbajtësit të autorizimit për armë, autorizimit për armë koleksioni apo autorizimit për mbajtje armë ka filluar një procedim penal për veprën penale të përmendur në nenin 12 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji ose procedim kundërvajtjeje për kundërvajtjen e përmendur në nenin 12 paragrafi 1 pika 2 të këtij ligji, organi përgjegjës do të marrë vendim për revokim të përkohshëm të autorizimit për armë, autorizimit për armë koleksioni apo autorizimit për mbajtje arme koleksioni, arme apo municioni deri në marrjen e vendimit përfundimtar, për të cilin njofton gjykatën.

Kundër vendimit të paragrafit 1 të këtij neni mund të paraqitet ankesë pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Ankesa kundër vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk e shtyn zbatimin e tij.

Neni 44

Në rastet e përmendura në nenin 41 dhe 42 të këtij ligji, organi përgjegjës do të marrë vendim për konfiskimin e armës ose municionit.

Kundër vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të paraqitet ankesë pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Ankesa kundër vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk e shtyn zbatimin e

tij.

Pas marrjes së vendimit përfundimtar të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, organi përgjegjës do të lëshojë një certifikatë dhe do t'i kërkojë zotëruesit ose personit juridik të shesë armën ose municionin brenda gjashtë muajve.

Nëse zotëruesi ose personi juridik nuk e dorëzon armën ose municionin brenda afatit të caktuar në paragrafin 4 të këtij neni, organi përgjegjës do të kryejë shitjen e armës dhe municionit përmes një ankandit publik të persona juridikë që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të armëve dhe municioneve dhe të personat fizikë që disponojnë leje për blerje arme. Për armët dhe municionet e shitura, zotëruesit ose personit juridik i korrespondon çmimi i shitjes duke zbritur shpenzimet për shitjen e tyre.

Nëse arma nuk shitet përmes ankandit publik, me armën do të veprohet sipas nenit 45 të këtij ligji.

Neni 45

Me armët dhe municionet e konfiskuara nga procedurat penale dhe kundërvajtjet veprohet në përputhje me një ligj të veçantë.

V. PRODHIMI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE, RIPARIMI DHE ÇAKTIVIZIMI I ARMËVE

Neni 46

Prodhimin e armëve dhe municioneve dhe riparimin e armëve mund ta kryejnë subjektet tregtare që kanë selinë në territorin e Republikës së Maqedonisë të cilat para regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar do të marrin lejen për ushtrimin e këtij aktiviteti.

Prodhim i armëve dhe municioneve, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohet çdo aktivitet i kërkimit, testimit, zhvillimit, përpunimit, përfundimit dhe montimit të pjesëve të armëve dhe municioneve, përveç aktiviteteve të kryera nga ana e zotëruesit të armës së gjuetisë ose armës sportive, për arsye të mbushjes së municionit për nevoja personale, që përdoret gjatë përdorimit të armëve të gjuetisë ose ato sportive.

Riparim arme, në kuptimin e këtij ligji, konsiderohet riparimi i defekteve të armës dhe zëvendësimi ose montimi i pjesëve origjinale për armët.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga organi përgjegjës, pas mendimit të marrë nga Ministria e Mbrojtjes dhe pëlqimit paraprak të marrë nga Ministria e Ekonomisë.

Neni 47

Lista e themeluesve të subjekteve tregtare i bashkëngjitet kërkesës për marrjen e lejes të përmendur në nenin 46.

Leja për prodhimin e armëve dhe municioneve dhe për riparimin e armëve do të lëshohet nëse:

1) Aplikanti dhe personi përgjegjës i personit juridik:

- plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 9 paragrafi 1 pika 2 deri në 4 të këtij ligji,
- janë shtetas të Republikës së Maqedonisë, dhe
- në momentin e dorëzimit të kërkesës kanë vendbanim të përhershëm në territorin e Republikës së Maqedonisë, dhe

Republikës së Maqedonisë, dhe

2) plotësohen kriteret hapësinore dhe teknike për prodhimin, riparimin dhe magazinimin e sigurt të armëve dhe municioneve, për mbrojtje nga zjarri, shpërthimet, ndotja, vjedhja dhe qasja nga persona të paautorizuar.

Plotësimi i kriterëve të paragrafit 2 pika 2 të këtij neni përcaktohet nga Komisioni i formuar nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Subjekti tregtar të cilit i është lëshuar leja e përmendur në nenin 46 të këtij ligji, ka për detyrë që brenda 15 ditëve nga fillimi i prodhimit të armëve dhe municioneve, apo riparimit të armëve të njoftojë organin përgjegjës.

Ministri i Punëve të Brendshme në pajtueshmëri me Ministrin e Transportit dhe Komunikacionit dhe Ministrin e Ekonomisë do të miratojnë rregullore të detajuara për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet ku do të kryhet prodhimi dhe riparimi, apo tregtimi dhe magazinimi i armëve dhe municioneve.

Neni 48

Leja e përmendur në nenin 46 të këtij ligji mund të lëshohet për prodhimin dhe riparimin e të gjitha llojeve të armëve dhe municioneve, që mund të blihen mbi bazë të një lejeje, ose për lloje të caktuara të armëve dhe municioneve.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përfundon së qenuri e vlefshme nëse subjekti tregtar nuk e nis ushtrimin e aktivitetit brenda një viti nga lëshimi i saj.

Afati i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, mund të zgjatet, nëse paraqiten rrethana që ndikojnë në nisjen e prodhimit dhe riparimit të të gjitha llojeve të armëve dhe municioneve, por vetëm për një vit më shumë.

Neni 49

Subjektet tregtare që ushtrojnë aktivitetin e riparimit të armëve kanë për detyrë të pranojnë për riparim vetëm armë të regjistruara.

Subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë të lëshojnë certifikatë për çdo riparim të kryer të armëve.

Pas përfundimit të riparimit të pjesëve kryesore të armëve të zjarrit, subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë të kryejnë qitje eksperimentale të armës.

Subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë që brenda pesë ditëve nga realizimi i qitjeve eksperimentale të armës të dorëzojnë një raport për këto të fundit pranë organit përgjegjës.

Raporti i përmendur në paragrafin 4 të këtij neni, duhet të përmbajë të dhënat për personin fizik apo personin juridik, të cilit i përket arma me të cilën janë realizuar qitjet eksperimentale dhe të dhënat për armën. Bashkangjitur raportit dorëzohen të paktën dy fishekë nga qitjet eksperimentale të kryera.

Neni 50

Armët dhe municionet në proces prodhimi dhe riparimi nuk mund të përdoren nga personat që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 9 paragrafi 1 pika 1, 2, 3, 4 dhe 6 të këtij ligji.

Subjektet tregtare kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtje teknike dhe fizike të vazhdueshme në ambientet ku ruhen armët dhe municionet.

Neni 51

Armët që janë pranuar për riparim nuk duhet të nxirret jashtë ambientit të punës, vetëm nëse është e nevojshme për testimin e armës.

Për testimin e armës së riparuar, subjekti tregtar që disponon lejen e përmendur në nenin 46 të këtij ligji mund të blejë dhe mbajë lloje dhe sasi të ndryshme municioni në bazë të lejes për blerje municioni.

Neni 51-a

Çaktivizimi i përhershëm i armëve të zjarrit realizohet duke ndërmarrë një nga procedurat

teknike të mëposhtme:

- foleja e fishekëve të ketë tre vrima të vendosura në mënyrë të diagonale, në kënd 120 gradë, me një diametër të barabartë me kalibrin e tytës së armës ose foleja e fishekëve të jetë e mbyllur me shollë, që ndalon mbushjen e mëtejshme të armës me municion,
 - tyta e armës të jetë e mbyllur (e mbushur) me metal gjatë gjithë gjatësisë ose vetëm në pjesën e folesë së fishekëve apo gjatë gjatësisë së saj,
 - tyta e armës të jetë e prerë gjatë gjithë gjatësisë së saj, me thellime të paktën 5 milimetra gjerësi, që fillojnë nga brendësia e saj dhe mbarojnë te hapja e tytës,
 - e gjithë pjesa e mekanizmit të mbylljes (shuli) të hiqet apo pritët me kënd 45 gradë ose hapja e daljes së gjilpërës gjuajtëse të mekanizmit të mbylljes me nxjerrësin të jetë përgjithmonë e mbyllur, dhe gjilpëra gjuajtëse të jetë hequr dhe
 - tyta e armës të jetë e mbyllur në përputhje me paragrafin 1 pika 2 dhe 3 të këtij neni.
- Foleja e fishekëve të revolverit të ketë një vrimë diagonale, me diametër të barabartë me kalibrin e tytës së armës. Foleja e fishekëve e revolverit të jetë e mbyllur me shollë metalike, e cila mbulon të gjithë pjesën e brendshme të tytës.

Çaktivizimin e përhershëm të armëve të zjarrit mund ta kryejnë subjektet tregtare me seli në territorin e Republikës së Maqedonisë që kanë marrë leje për prodhimin e armëve dhe municioneve dhe riparimin e armëve.

Pas përfundimit të një prej procedurave teknike të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, subjektet tregtare të paragrafit 2 të këtij neni kanë për detyrë të lëshojnë një certifikatë për procedurën e kryer për çaktivizimin e përhershëm të armës.

Zotëruesi i armës së cilës i është kryer çaktivizimi i përhershëm ka për detyrë që brenda tetë ditëve të paraqesë armën dhe certifikatën e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, pranë Komisionit të formuar nga ana e Ministrisë të Punëve të Brendshme, i cili lëshon certifikatën se arma është çaktivizuar përgjithmonë për përdorim.

Është i ndaluar aktivizimi (riaktivizimi) për përdorim i armës, e cila është çaktivizuar përgjithmonë nga ana e subjekteve tregtare të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni dhe nga zotëruesi ose përdoruesi i armës.

Neni 51-b

Çaktivizimi i përhershëm i armëve të zjarrit realizohet duke ndërmarrë një nga procedurat teknike të mëposhtme:

- brenda tytës së armës të vendoset një tel, fundet e të cilit të bashkohen me vulosje metalike ose
- këmbëza e armës të çaktivizohet (bllokohet) me vulosje.

Dispozitat e nenit 51-a paragrafi 2, 3 dhe 4 të këtij ligji zbatohen përkatësisht për çaktivizimin e përkohshëm të armës së zjarrit.

Arma e cila është çaktivizuar përkohësisht për përdorim mund të aktivizohet, apo riaktivizohet nga ana e subjekteve tregtare të përmendura në nenin 51-a paragrafi 2 të këtij ligji me kërkesë të personit fizik mbi bazë të lejes së lëshuar për blerje arme.

VI. TREGTIMI I ARMËVE, MUNICIONEVE DHE PJESËVE TË ARMËS

Neni 52

Tregtimi i armëve, municioneve dhe pjesëve të armës mund të kryhet nga subjektet tregtare me seli në territorin e Republikës së Maqedonisë të cilat para regjistrimit në regjistrin tregtar do të marrin leje për kryerjen e atij aktiviteti.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga autoriteti kompetent mbi bazën e kërkesës së paraqitur.

Kërkesa dhe leja të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni dorëzohen apo lëshohen edhe

në formë elektronike.

Tregtim i armëve, municioneve dhe pjesëve të armës në kuptimin e këtij ligji konsiderohet blerja e armëve, municioneve dhe pjesëve të armës, për shitje, transferim, ndërmjetësim, magazinim dhe ruajtje të armëve dhe municioneve dhe shitja e tyre me pakicë dhe shumicë.

Subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë të kryejnë tregtim vetëm të armëve dhe municioneve të markuara në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.

Subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund t'u shesin armë dhe municione vetëm personave fizikë dhe juridikë që disponojnë leje për blerje arme.

Dispozitat e nenit 47, 48 dhe 50 të këtij ligji zbatohen përkatësisht për subjektet tregtare që kryejnë tregtimin e armëve dhe municioneve.

Subjektet tregtare mund t'u shesin municion për armë, personave fizikë, në përputhje me nenin 7 paragrafi 5 dhe 6 të këtij ligji dhe municion për armë personave juridikë që kryejnë sigurimin e personave dhe të pronës në përputhje me nenin 7 paragrafi 7 të këtij ligji.

Neni 53

Në treg mund të hidhen armët, municionet dhe pjesët e armëve që janë të ekzaminuara, vulosura apo të markuara në përputhje me rregulloret për ekzaminimin dhe vulosjen, apo markimin e armëve të zjarrit dhe municioneve.

Neni 54

Magazinat për sistemimin e armëve dhe municioneve dhe objektet ku realizohet tregtimi i armëve dhe municioneve duhet të plotësojnë kriteret për sistemim dhe ruajtjen e substancave shpërthyesë, të përcaktuara me ligj.

Neni 55

Transferimi i armëve, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton eksportin, importin dhe transitin e një sasive të paracaktuar me kontratë të armëve dhe municioneve, ndërmjet subjekteve tregtare të përmendura në nenin 46 paragrafi 1 dhe nenin 52 paragrafi 1 të këtij ligji dhe subjekteve tregtare të shteteve të tjera. Transferimi i armëve dhe municioneve realizohet nga ana e subjekteve tregtare të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të cilat do të pajisen me leje të lëshuar nga organi përgjegjës, me mendim paraprak të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Kërkesa për lëshimin e lejes së përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përmban:

- emrin e shoqërisë dhe selinë, apo emrin dhe adresën e dërguesit dhe marrësit;
- emrin e shoqërisë dhe selinë e prodhuesit të armëve dhe municioneve dhe
- llojin, markën, kalibrin dhe sasinë e armëve dhe municioneve.

Personi që paraqet kërkesën për leje të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni ka për detyrë të dorëzojë dhe:

- certifikatën e përdoruesit fundor të lëshuar nga organi përgjegjës dhe
- kontratën ose dokument tjetër për sasinë e kontraktuar të armëve.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, lëshohet me afat përdorimi deri në gjashtë muaj.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, shfuqizohet nëse merren masat kufizuese në përputhje me rregulloret për masat kufizuese ndërkombëtare.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dorëzohen dhe lëshohen edhe në formë elektronike.

Armët dhe municionet që kalojnë transit përmes territorit të Republikës së Maqedonisë nuk markohen në përputhje me nenin 53 të këtij ligji.

Neni 55-a

Subjektet tregtare të përmendura në nenin 55 paragrafi 2 të këtij ligji, që importojnë armë, kanë për detyrë që armët t'i markojnë me etiketën për import.

Etiketa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të stampohet në pjesën e armës së zjarrit ku stampohen dhe etiketa të tjera të armës.

Etiketa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë në formë rrethi me diametër deri në dy milimetra, e stampuar në armë në thellësi të paktën 0,08 milimetra.

Etiketa e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përmban kodin ndërkombëtar të shtetit ku importohet arma dhe vitin e importit të armës.

(Neni 55-a do të shfuqizohet në ditën e fillimit të zbatimit të ligjit "Për ekzaminimin dhe vulosjen, apo markimin e armëve të zjarrit dhe municioneve" ("Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 25/10)

VII. TRANSPORTI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE

Neni 56

Për transportin e armëve dhe municioneve nevojitet leja nga organi përgjegjës.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet për subjektet tregtare që kryejnë aktivitetin e tregtimit të armëve dhe municioneve.

Subjektet tregtare të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni paraqesin kërkesën për lëshimin e lejes për transportin e armëve dhe municioneve, që përmban:

- emrin e shoqërisë dhe selinë, apo emrin dhe adresën e dërguesit, transportuesit dhe marrësit,

- emrin e shoqërisë dhe selinë e prodhuesit të armëve dhe municioneve,

- llojin, markën, kalibrin, kategorinë dhe sasinë e armëve dhe municioneve,

- drejtimin e lëvizjes dhe vendin e magazinimit,

- llojin e mjetit transportues, numrin e targës, emrin e shoferit dhe dokumentin personal të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë) të shoferit dhe

- masat e sigurisë gjatë transportit.

Nëse organi përgjegjës ka lëshuar lejen e përmendur në nenin 55 paragrafi 1 të këtij ligji, kërkesa për transportin e armëve dhe municioneve, përveç të dhënave të kërkuara në paragrafin 3 të këtij neni, përmban edhe emrin e pikës së kalimit kufitar përmes së cilës do të transportohen armët.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet me një afat vlefshmërie deri në tre muaj.

Kërkesa e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni dhe leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, dorëzohen dhe lëshohen edhe në formë elektronike.

Ministri i Punëve të Brendshme, ose një person i autorizuar prej tij, sipas nevojës, do të përcaktojë marrjen e masave të veçanta për sigurinë gjatë transportit të armëve dhe municioneve në përputhje me ligjin.

Neni 57

Për transportin e municioneve zbatohen përkatësisht rregulloret për transportin e substancave shpërthyes.

VIII. POLIGONET CIVILE TË QITJES

Neni 58

Poligonet civile të qitjes janë objekte të përcaktuara për ushtrime sportive në qitje, si dhe për

aftësimin praktik të përdorimit të armës, që plotësojnë kriteret teknike dhe të sigurisë për përdorimin e armëve të zjarrit, ato sportive dhe të gjuetisë.

Poligonet civile të qitjes mund të ndërtohen nga persona juridikë, që përveç kushteve për regjistrimin në regjistrin tregtar, do të marrin dhe lejen nga organi përgjegjës.

Dispozitat e neneve 47, 48 dhe 50 të këtij ligji zbatohen përkatësisht edhe për ndërtimin e poligoneve civile të qitjes.

Dispozitat e këtij ligji për poligonet civile të qitjes nuk zbatohen për terrenet e përcaktuara për gjueti që shoqatat e gjuetarëve (përdoruesit e terrenit për gjah ose pronarët e terrenit për gjueti) i përdorin për gjuajtje dhe testimin e armëve të gjuetisë në përputhje me rregulloret për gjueti.

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë rregullore të detajuara për kushtet minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 58-a

Personat juridikë të përmendur në nenin 58 paragrafi 2 të këtij ligji kanë për detyrë të miratojnë rregulloren e brendshme për poligonin civil të qitjes, brenda 30 ditëve nga dita e ndërtimit të poligonit.

Organi përgjegjës jep miratimin e tij për rregulloren e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 59

Qitje në poligonin civil të qitjes mund të kryejnë vetëm personat fizikë të cilët me këtë ligj ose me një tjetër janë të autorizuar të mbajnë këto lloj arme ose kanë paraqitur kërkesë për blerje arme.

Personat fizikë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni kanë për detyrë që gjatë qitjes të mbajnë syze mbrojtëse dhe mbrojtëse për veshët.

Neni 59-a

Aftësimi praktik për qitje me armë i personave fizikë në poligonet civile të qitjes mund të kryhet nga personat juridikë në bazë të autorizimit të marrë në përputhje me nenin 14 të këtij ligji, duke përdorur armët e blera posaçërisht për këtë qëllim.

Neni 60

Poligonet civile të qitjes mund të blejnë armë dhe sasi të nevojshme municioni për qitjet në poligon, si dhe për aftësimin praktik për përdorimin e armës në bazë të lejes së lëshuar nga organi përgjegjës.

Organi përgjegjës do të lëshojë lejen për blerje arme sipas paragrafit 1 të këtij neni, nëse në poligonin civil të qitjes ka ambient për magazinimin dhe ruajtjen e sigurt të armëve.

Organi përgjegjës do të lëshojë leje për blerje të shumëfishtë municioni me afat deri në një vit, për sasi në varësi të kapacitetit për magazinim dhe volumit të përdorimit të municioneve.

IX. TRANSFERIMI I ARMËVE DHE MUNICIONEVE PËRMES KUFIRIT SHTETËROR

Neni 61

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë dhe shtetasit e huaj mund të transferojnë përmes kufirit shtetëror vetëm ato lloje armësh dhe municionesh, që në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të blihen, posedohen dhe mbahen dhe për të cilat është lëshuar leje nga organi përgjegjës.

Gjatë transferimit të armëve dhe municioneve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni,

shtetasit e Republikës së Maqedonisë dhe shtetasit e huaj kanë për detyrë të deklarojnë armët dhe municionet që mbajnë me vete dhe të paraqesin për inspektim lejen e lëshuar nga organi përgjegjës pranë oficerit të policisë në pikën e kalimit kufitar ku do të kalohet kufiri shtetëror.

Nëse oficeri i policisë gjatë kontrollit të personit fizik të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, apo gjatë kontrollit të mjetit të transportit të personit, gjen armë dhe municione që nuk janë deklaruar, apo për të cilat nuk është paraqitur për inspektim leja e lëshuar nga organi përgjegjës, me vendim sekuestrohen përkohësisht armët dhe municionet deri në përfundim të procedurës ligjore ose procedurës penale, me vendim të prerë gjykate.

Kundër vendimit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni mund të paraqitet një ankesë pranë Komisionit brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit.

Ankesa kundër vendimit të përmendur në paragrafin 3 të këtij neni nuk e shtyn afatin e ekzekutimit të tij.

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë akte nënligjore për mënyrën e transferimit të armëve dhe municioneve përmes kufirit shtetëror.

Neni 62

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë me qëndrim të përhershëm jashtë vendit dhe shtetasit e huaj mund të sjellin në Republikën e Maqedonisë, armë dhe municione për gjueti me qëllim gjuetie, nëse për to është lëshuar leje për mbajtje arme gjahu për arsye gjuetie nga organi përgjegjës ose dokument tjetër përkatës i lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër si dhe ftesa për pjesëmarrje në gjueti.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga ana e oficerit të policisë në pikën e kalimit kufitar ku realizohet kalimi i kufirit shtetëror.

Neni 63

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë mund të nxjerrin armë dhe municione për ato armë jashtë territorit, nëse disponojnë autorizim për armën ose autorizim për mbajtje arme të lësuara nga organi përgjegjës.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë me qëndrim të përhershëm në një shtet të huaj dhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë që emigrojnë nga Republika e Maqedonisë, dhe nuk kanë autorizim për armë, mund të blejnë dhe të nxjerrin armë dhe municione nga Republika e Maqedonisë vetëm në bazë të një lejeje të lëshuar nga organi përgjegjës.

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni kanë për detyrë që të raportojnë pranë zyrtarëve të autorizuar armët dhe municionet që mbajnë me vete gjatë kalimit të kufirit shtetëror.

Neni 64

Shtetasit e Republikës së Maqedonisë që kanë qëndruar jashtë vendit dhe e kalojnë kufirin shtetëror me qëllim për të jetuar përgjithmonë në Republikën e Maqedonisë, si dhe shtetasit e huaj që kanë qëndrim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë dhe që kanë qëllim të sjellin armë në Republikën e Maqedonisë, për të cilat është lëshuar autorizim nga organi përgjegjës i një shteti tjetër, kanë për detyrë që brenda 30 ditëve nga dita e deklarimit të vendbanimit ose vendqëndrimit, apo nga dita e marrjes së vendimit për qëndrim të përhershëm, të paraqesin personalisht një kërkesë pranë organit përgjegjës për zëvendësimin e autorizimit për armën të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër me autorizim për armë, apo autorizim për mbajtje arme nga organi përgjegjës.

Armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni hyjnë në Republikën e Maqedonisë, brenda 30 ditëve nga dita e lëshimit të lejes për futjen e armëve dhe municioneve nga organi përgjegjës.

Neni 65

Shtetasit e huaj mund të blejnë dhe të nxjerrin armë jashtë Republikës së Maqedonisë në bazë të lejes për blerje dhe nxjerrje të armëve dhe municioneve nga Republika e Maqedonisë e lëshuar nga organi përgjegjës, në bazë të miratimit paraprak ose dokumenti tjetër të përshtatshëm për blerje arme të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër.

Shtetasit e huaj të cilët kalojnë përmes Republikës së Maqedonisë mund të sjellin në Republikën e Maqedonisë dhe të mbajnë armë dhe municione, nëse për këtë disponojnë leje nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë në shtetin e huaj ose nga organi përgjegjës.

Neni 66

Pjesëtarët e institucioneve të huaja ushtarake i transportojnë dhe mbajnë armët e zjarrit në Republikën e Maqedonisë në mënyrën e parashikuar në rregulloret për mbikëqyrjen e kufirit shtetëror.

Neni 67

Shtetasit e huaj që vijnë në Republikën e Maqedonisë për qëllime gjuetie kanë për detyrë që, gjatë kalimit të kufirit shtetëror, armët e gjahut dhe municionet që mbajnë me vete t'i deklarojnë tek oficerët e policisë.

Organi përgjegjës, gjatë kontrollit në momentin e kalimit të kufirit shtetëror, do t'i lëshojë shtetasve të huaj të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni një leje për mbajtje arme gjahu gjatë kohës së gjuetisë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 68

Anëtarët e organizatave të qitësve që udhetojnë në grup ose individualisht jashtë vendit për pjesëmarrje në konkurse qitjesh ose për përgatitje për konkurse të tilla, mund të transportojnë përmes kufirit shtetëror armë dhe municione të nevojshme për atë qëllim në bazë të lejes së lëshuar nga organi përgjegjës.

Anëtarët e organizatave të huaja të qitjes mund të transportojnë armë sportive në Republikën e Maqedonisë me kusht që të posedojnë një leje për mbajtje armësh sportive për pjesëmarrje në konkurse qitjeje ose për përgatitje për konkurse qitjesh, të lëshuar nga organi përgjegjës ose një leje tjetër përkatëse të lëshuar nga organi përgjegjës i një shteti tjetër.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga ana e oficerit të policisë në pikën e kalimit kufitar ku do të kalohet kufiri shtetëror.

Neni 69 është fshirë

Neni 70

Armët sportive dhe të gjahut dhe municionet për këto armë që janë sekuestruar nga organet doganore u shiten personave juridikë, përmes një ankandi publik, të cilët merren me veprimtarinë e tregtimit të armëve dhe municioneve dhe personave fizikë që kanë leje për blerje armësh.

Me armët dhe municionet e tjera që janë sekuestruar nga organet doganore veprohet në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

Neni 71

Armët dhe municionet nuk mund të transportohen përmes pikave kufitare për trafik kufitar, vetëm nëse me marrëveshje ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.

X. SHTETASIT E VENDEVE ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN

Neni 72

Shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian mund të sjellin në Republikën e Maqedonisë armë për të cilat u është lëshuar dokumenti evropian për armë në bazë të lejes paraprake të lëshuar nga organi përgjegjës.

Për transitin e armëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni leja lëshohet nga organi përgjegjës.

Kërkesa për lëshimin e lejes së përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni mund të dorëzohet edhe pranë përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Republikës së Maqedonisë në shtetin ku qëndron personi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Leja e përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni lëshohet me afat vlefshmërie deri në një vit dhe regjistrohet në dokumentin evropian për armët. Leja mund të zgjatet edhe për një vit.

Leja e përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të lëshohet nëse kjo është e nevojshme për arsye të sigurisë së shtetit ose rendit publik dhe paqes.

Nuk është e nevojshme të lëshohet leja e përmendur në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni për anëtarët e shoqatave të gjuetarëve dhe anëtarët e shoqatave sportive të qitjes nëse për armët është lëshuar dokumenti evropian për armët nën kushtet që vërtetohet se qëllimi i udhëtimit në Republikën e Maqedonisë është pjesëmarrja në konkurse gjuetie ose sportive.

Neni 73

Një shtetas i një vendi anëtar të Bashkimit Evropian mund të sjellë dhe të transportojë në Republikën e Maqedonisë armë për të cilat është lëshuar dokumenti evropian për armët në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe në përputhje me këtë ligj.

Me kërkesë të një shtetasi të një vendi anëtar të Bashkimit Evropian që ka leje qëndrimi në territorin e Republikës së Maqedonisë, organi përgjegjës do t'i lëshojë një dokument evropian për armë me kusht që për armën të jetë lëshuar një autorizim në përputhje me këtë ligj.

Për sekuestrimin e armëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni dhe për revokimin e dokumentit evropian për armët të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni zbatohen përkatësisht dispozitat e këtij ligji.

Neni 74

Ministri i Punëve të Brendshme do të përcaktojë formularin e lejes për sjelljen e armëve dhe të dokumentit evropian për armët.

XI. REGJISTRAT

Neni 75

Ministria e Punëve të Brendshme mban regjistra për lejet e lëshuara për blerje arme, kërkesat e paraqitura për regjistrimin e armëve, kërkesat për zëvendësimin e autorizimeve ekzistuese, autorizimet për armë, autorizimet për posedim arme, autorizimet për mbajtje arme, certifikatat për posedim arme, lejet për blerje arme koleksioni, kërkesat e paraqitura për regjistrimin e armëve të koleksionit, lejet për armët e koleksionit, koleksionistët, për armët e deklaruar të kategorisë D, armët dhe municionet e sekuestruara, të gjetura dhe të dorëzuara, lejet për prodhim dhe riparim, certifikatat për armët e zjarrit me çaktivizim të përhershëm, lejet për tregtim, lejet për transferimin e armëve, lejet për transportin, lejet për ndërtimin e poligoneve civile të qitjes, lejet për blerjen dhe eksportin e armëve dhe municioneve jashtë shtetit, lejet për sjelljen e armëve dhe municioneve në vend, lejet për sjelljen e armëve dhe municioneve të lëshuara nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, lejet për posedim dhe mbajtje të armëve të gjahut gjatë kohës së gjuetisë në vend, lejet për transportin e armëve

sportive dhe lejet për transitin e armëve dhe municioneve.

Neni 76

Shoqatat e gjuetarëve dhe ato të qitjes, personat juridikë përdorues të terrenit për gjueti dhe persona të tjerë juridikë që posedojnë armë në bazë të autorizimit për posedim arme kanë për detyrë të mbajnë regjistër për armët dhe municionet si dhe për personat të cilëve u japin armët për përdorim.

Regjistri i armëve dhe municioneve duhet të mbahet edhe nga subjektet tregtare që kryejnë aktivitetet vijuese:

- prodhim të armëve dhe municioneve, për armët dhe municionet e prodhuara dhe të porositura;
- riparim të armëve, për armët e riparuar;
- çaktivizim të armëve, për armët që çaktivizohen përkohësisht ose përgjithmonë, si dhe për certifikatat e lëshuara për procedurat teknike të kryera për çaktivizimin e armëve dhe
- tregtim të armëve dhe municioneve, për armët dhe municionet e blera dhe të shitura.

Subjektet tregtare kanë për detyrë të mbajnë regjistra dhe për fishekët e shkrepur për çdo armë.

Poligonet civile të qitjes kanë për detyrë të mbajnë regjistra për municionin e vënë në dispozicion dhe të përdorur.

Neni 77

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë rregullore të detajuara për formularin e kërkesës për lëshimin e lejes për blerje arme, pjesëve të armës dhe municionesh, kërkesës për zëvendësimin e autorizimit për armë të lëshuar nga organi përgjegjës i shtetit tjetër, kërkesës për regjistrimin e armës, kërkesës për regjistrimin e armës së koleksionit, kërkesës për zëvendësimin e autorizimeve ekzistuese, lejes për blerje arme, pjesëve të armës dhe municioneve, lejen për blerje armësh koleksioni, autorizimit për armë, autorizimit për posedim arme dhe për mbajtje armë, autorizimit për armë koleksioni, certifikatës për posedim arme, certifikatës për posedimin e armëve me çaktivizim të përkohshëm, certifikatës për deklarimin e armëve të kategorisë D, certifikatës për armët e zjarrit me çaktivizim të përhershëm, certifikatës për armët e zjarrit të çaktivizuara përkohësisht në përputhje me nenin 39 paragrafi 6 të këtij ligji, lejes për prodhimin, riparimin, tregtimin dhe transportin e armëve dhe municioneve, lejes për transferimin e armëve dhe municioneve, certifikatës së përdoruesit fundor, lejes për blerjen dhe nxjerrjen e armëve dhe municioneve jashtë shtetit, lejes për sjelljen e armëve dhe municioneve në vend, lejes për sjelljen e armëve dhe municioneve në vend të lëshuar nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, lejes për posedimin dhe mbajtjen e armëve të gjahut gjatë kohës së gjuetisë, lejes për transportin e armëve sportive dhe lejes për transitin e armëve dhe municioneve, lejes për ndërtimin e poligoneve civile të qitjes dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave për armët dhe municionet.

Për qëllime të këtij ligji, përpunimi i të dhënave vijuese personale parashikohet në rregulloren e paragrafit 1 të këtij neni:

- 1) emri;
- 2) data dhe vendlindja;
- 3) shtetësia;
- 4) numri i pasaportës;
- 5) vendbanimi i përhershëm ose i përkohshëm dhe adresa, si dhe
- 6) numri personal i identifikimit të shtetasit.

Të dhënat personale të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni ruhen deri në pesë vite.

Neni 77-a

Ministri i Punëve të Brendshme do të miratojë akte nënligjore për formën dhe përmbajtjen e formularëve të kërkesave dhe lejeve të përmendura në nenin 52, 55 dhe 56 të këtij ligji, që paraqiten apo lëshohen në formë elektronike.

Për qëllime të këtij ligji, përpunimi i të dhënave vijuese personale për drejtuesin e mjetit që transporton armë dhe municione parashikohet në rregulloren e paragrafit 1 të këtij neni:

- 1) emri;
- 2) vendbanimi i përhershëm ose i përkohshëm dhe adresa;
- 3) numri i pasaportës;
- 4) shtetësia; dhe
- 5) licenca ADR e drejtuesit të mjetit.

XII. MBIKËQYRJA

Neni 78

Mbikëqyrja për respektimin e kriterëve të përcaktuara për prodhimin, riparimin, çaktivizimin, tregtimin, magazinimin dhe ruajtjen e armëve dhe municioneve, sistemimin dhe ruajtjen e armëve pjesë të koleksionit të armëve të koleksionuara, i përbërë nga mbi 25 copë armë, përdorimin e poligoneve të qitjes, si dhe baza ligjore për posedimin dhe mbajtjen e armëve dhe municioneve dhe mbajtjen e regjistrave të përcaktuar me këtë ligj, realizohet nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Personat fizikë dhe juridikë të autorizuar kanë për detyrë të mundësojnë realizimin e mbikëqyrjes, kontrollit të armëve, të vendosin në dispozicion dokumentacionin përkatës dhe të japin të dhënat dhe njoftimet e nevojshme.

Ministri i Punëve të Brendshme e revokon lejen për prodhimin, riparimin, tregtimin e armëve dhe municioneve ose për përdorimin e poligoneve civile të qitjes, nëse konstaton se kanë pushuar së ekzistuari kushtet për lëshimin e lejes të parashikuar me këtë ligj ose nëse nuk do të hiqen parregullsitë e konstatuara brenda afatit të caktuar.

Subjekti tregtar të cilit i është revokuar leja për prodhimin, riparimin ose tregtimin e armëve dhe municioneve ose për përdorimin e poligoneve civile të qitjes, mund të depozitojë një kërkesë për lëshimin përsëri të lejes pas kalimit të periudhës prej në viti nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për revokimin e autorizimit.

Pas hyrjes në fuqi të vendimit, organi përgjegjës e njofton gjykatën që të ndër marrë masat përkatëse për përfundimin e kryerjes së aktivitetit të subjektit tregtar.

Armët dhe municionet të cilat i disponojnë subjektet tregtare do t'i dorëzohen organit përgjegjës brenda 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

Armët dhe municionet e përmendura në paragrafin 6 të këtij neni, do t'u shiten personave juridikë që merren me tregtimin e armëve dhe municioneve dhe personave fizikë që disponojnë lejen për blerje arme nëpërmjet një ankandi publik.

Të ardhurat e realizuara nga shitja e armëve dhe municioneve janë të ardhura për subjektin tregtar.

XIII. DISPOZITAT E SANKSIONEVE

Neni 79

Një person juridik do të gjobitet me 1000 deri në 5000 euro ekuivalente në dinarë nëse blen, posedon, prodhon, riparon, shkëmben ose i jep një subjekti tjetër armë dhe municione blerja, posedimi, mbajtja, prodhimi, riparimi dhe tregtimi i të cilave është i ndaluar (neni 4 paragrafi 2).

Për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personit juridik do t'i caktohet masa e ndalimit të përkohshëm të kryerjes së aktivitetit të prodhimit, riparimit ose tregtimit të

armëve, pjesëve të armëve dhe municioneve, apo masa e ndalimit të përdorimit të poligonit civil të qitjes, për një periudhë nga një deri në pesë vjet dhe masa shtrënguese e veçantë e konfiskimit të armëve, municioneve apo pjesëve të armëve.

Neni 80

Një gjobë prej 600 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit fizik që:

- 1) blen, posedon, prodhon, riparon, çaktivizon, shet, shkëmben, transporton ose i jep dikujt tjetër, armë, pjesë të armëve dhe paralizues elektrikë të përmendur në nenin 4 paragrafi 2 të këtij ligji, përveç armëve të zjarrit dhe municioneve të përmendura në nenin 4 paragrafi 2 të këtij ligji;
- 2) blen pjesë të armëve në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 2 të këtij ligji;
- 3) posedon municione në sasi më të mëdha se ato që janë përcaktuar me nenin 7 paragrafi 5 të këtij ligji;
- 4) mban dhe përdor armë për të cilat është lëshuar leje për posedim arme në përputhje me nenin 21 paragrafi 4 të këtij ligji;
- 5) mban armë në kundërshtim me dispozitat e nenit 24 të këtij ligji;
- 6) blen armë koleksioni në kundërshtim me dispozitat e nenit 26-a të këtij ligji;
- 7) posedon armë të kategorisë D për të cilat nuk është lëshuar leje nga organi përgjegjës (neni 27 paragrafi 2);
- 8) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 të këtij ligji;
- 9) fshin ose dëmton shenjat që janë vulosur në armë (neni 28 paragrafi 2);
- 10) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 29 të këtij ligji;
- 11) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 30 të këtij ligji;
- 12) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 të këtij ligji;
- 13) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 të këtij ligji dhe
- 14) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 51-a të këtij ligji.

Për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, do të caktohet masa shtrënguese e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Neni 81

Një gjobë prej 500 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit fizik që:

- 1) nuk paraqet kërkesën brenda afatit të caktuar pranë organit përgjegjës për regjistrimin e armës dhe lëshimin e autorizimit për armën (neni 18 paragrafi 1);
- 2) nuk ka certifikatë për transportin e armëve nga depoja e armëve të shoqatës së qitjes deri te vendi i qitjes ose terrenit të caktuar për këtë qëllim, si dhe anasjelltas (neni 26 paragrafi 2);
- 3) nuk deklaron brenda afatit të caktuar blerjen e armëve të kategorisë D (neni 27 paragrafi 2);
- 4) nuk tregon autorizimin për armë dhe autorizimin për mbajtje arme me kërkesë të personit zyrtar të autorizuar të organit përgjegjës (neni 32 paragrafi 2);
- 5) nuk raporton brenda afatit të caktuar zhdukjen, humbjen ose vjedhjen e armëve dhe municioneve, lejes për blerje arme, autorizimit për armët dhe autorizimit për mbajtje arme, lejes për blerje të armëve të koleksionit dhe autorizimit për armë koleksioni (neni 36);
- 6) gjatë ndryshimit të vendbanimit ose vendqëndrimit nuk do të deklarojë armët brenda afatit të caktuar pranë organit përgjegjës në zonën ku ndodhet vendbanimi ose vendqëndrimi i ri (neni 38);
- 7) në rast vdekjeje të zotëruesit të armës, nuk do të dorëzon armët dhe municionet brenda afatit të caktuar (neni 39 paragrafi 1);

8) armët dhe municionet e çaktivizuara përkohësisht nuk do t'i ruajë në vendin e banimit ose të qëndrimit, apo në vendin në të cilin ka një leje të përhershme qëndrimi, deri në përfundim të procedurës së trashëgimisë (neni 39 paragrafi 2);

9) gjatë qitjes në poligonet civile të qitjes nuk mban syze mbrojtëse dhe mbrojtje për veshët (neni 59 paragrafi 2);

10) gjatë kalimit të kufirit shtetëror nuk deklaron pranë organit përgjegjës armët dhe municionet që mban me vete (neni 61 paragrafi 2, neni 63 dhe 67);

11) nxjerr nga Republika e Maqedonisë armë dhe municione pa leje kur është e nevojshme një leje e tillë (neni 63 dhe 65);

12) nuk paraqet kërkesën për zëvendësimin e autorizimit për armë brenda afatit të caktuar (neni 64);

13) transferon ose përpiqet të transferojë armë ose municione përmes kufirit shtetëror të hapur për trafik kufitar, vetëm nëse është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare (neni 71) dhe

14) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 78 paragrafi 2 të këtij ligji.

Për shkeljen e përcaktuar në paragrafin 1 pikat 1 dhe 3 të këtij neni, personit fizik do t'i caktohet masa administrative e veçantë e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Neni 82

Një gjobë prej 2000 deri në 5000 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit juridik që:

1) kryen shitje të armëve të kategorisë D te personat që nuk plotësojnë kriterin e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 1 pika 1 të këtij ligji (neni 27 paragrafi 1);

2) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 të këtij ligji,

3) i shet ose i jep për përdorim armë dhe municione personave të cilët nuk janë të pajisur me leje për blerje arme, autorizim për armë ose autorizim për mbajtje arme (neni 29);

4) mban armë në kundërshtim me dispozitat e nenit 34 të këtij ligji;

5) nuk njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme për fillimin e aktivitetit të prodhimit të armëve dhe municioneve, apo riparimit të armëve brenda afatit të caktuar (neni 47 paragrafi 4);

6) pranon për riparim armë që nuk janë të regjistruara (neni 49);

7) nuk siguron ambientet ku ruhen armët dhe municionet nga aksesit i personave të paautorizuar me mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike (neni 50 paragrafi 2);

8) armët që ka pranuar për riparim janë nxjerrë jashtë ambientit të punës (neni 51 paragrafi 1);

9) nuk lëshon certifikatë për procedurën teknike të kryer për çaktivizimin e përhershëm të armëve (neni 51-a paragrafi 3);

10) Aktivizon (riaktivizon) për përdorim armë që janë çaktivizuar përgjithmonë për përdorim

(neni 51-a paragrafi 5);

11) kryen tregtimin e armëve dhe municioneve në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafët 4 dhe 5 të këtij ligji;

12) vendos në treg armë, municione dhe pjesë për armë që nuk janë të markuara, ekzaminuara, vulosura, pra të markuara në përputhje me rregulloret për ekzaminimin dhe vulosjen, pra markimin e armëve të zjarrit dhe municioneve (neni 53);

13) kryen transportin e armëve dhe municioneve pa lejen e lëshuar nga organi përgjegjës (neni 55 paragrafi 2);

14) nuk i markon armët e zjarrit të importuara me markimin përkatës për import (neni 55-a); (pika 14 do të shfuqizohet në ditën kur do të fillojë zbatimi i ligjit "Për ekzaminimin dhe vulosjen, pra markimin e armëve të zjarrit dhe municioneve" ("Fletorja Zyrtare e Republikës

së Maqedonisë” numër 25/10)

15) transporton armë dhe municione pa leje ose në kundërshtim me urdhrat për marrjen e masave të veçanta për sigurimin e transportit (neni 56 paragrafët 1 dhe 6);

16) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 58-a të këtij ligji dhe

17) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 78 paragrafi 2 të këtij ligji.

Një gjobë prej 200 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë ose një gjobë në vend prej 300 deri në 600 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet për shkeljet e përcaktuara në paragrafin 1 pikat 4 deri në 12 të këtij neni personit përgjegjës pranë personit juridik.

Për shkeljen e paragrafit 1 pikat 1, 2, 3, 5, 7, 8 dhe 12 të këtij neni do të caktohet një masë administrative e veçantë e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Për shkeljen e paragrafit 1 pikat 4 deri në 13 të këtij neni, do të caktohet sanksioni administrativ ndalim i përkohshëm i aktivitetit të prodhimit, riparimit, tregtimit ose transportit të armëve dhe municioneve, me afat të paktën nga një deri në pesë vite.

Neni 83

Një gjobë prej 1000 deri në 3500 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit juridik që:

1) nuk lëshon certifikatë për aftësimin praktik mbi përdorimin e armës për personin fizik, i cili bën kërkesë për leje për blerje arme (neni 14 paragrafët 5 dhe 6);

2) nuk paraqet kërkesë për regjistrimin e armës dhe për lëshimin e autorizimit për posedim arme brenda afatit të caktuar (neni 18);

3) nuk informon organin përgjegjës brenda afatit të caktuar (neni 23 paragrafi 5);

4) lëshon certifikatë për armën e gjuetisë të cilën ia jep për gjueti një ditore në zonën e përcaktuar për gjah personit i cili nuk është anëtar aktiv i shoqatës së gjuetarëve (neni 25);

5) U jep për përdorim armë personave që posedojnë autorizim për armë, por nuk janë anëtarë aktiv të shoqatës së gjuetarëve (neni 26 paragrafi 1);

6) nuk lëshon certifikatë për transportimin e armëve nga depoja e armëve të shoqatës së qitjes deri në vendin e qitjes, si dhe anasjelltas (neni 26 paragrafi 2);

7) nuk deklaron brenda afatit të caktuar zhdukjen, humbjen ose vjedhjen e armëve dhe municioneve, lejes për blerje arme, autorizimit për armë dhe autorizimit për mbajtje arme (neni 36);

8) në momentin e ndryshimit të selisë nuk e deklaron armën brenda afatit të caktuar pranë organit përgjegjës në zonën e selisë së re (neni 38);

9) nuk realizon brenda afatit të caktuar qitjet eksperimentale të armëve, pas riparimit të pjesëve kryesore të armëve të zjarrit (neni 49 paragrafi 4) dhe

10) nuk mban regjistra në përputhje me dispozitat e nenit 76 të këtij ligji.

Një gjobë prej 200 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë ose gjobë në vend prej 300 deri në 600 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit përgjegjës pranë personit juridik për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 pika 2 të këtij neni do të caktohet masa administrative e veçantë e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Neni 83-a

Një gjobë prej 600 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit fizik që vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 86 dhe 86-b të këtij ligji.

Për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, personit fizik do t'i caktohet masa administrative e veçantë e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Neni 83-b

Një gjobë prej 2000 deri në 5000 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit

juridik që vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 86 dhe 86-b të këtij ligji.

Një gjobë prej 200 deri në 1000 euro ekuivalente në dinarë ose gjobë në vend prej 300 deri në 600 euro ekuivalente në dinarë do t'i caktohet personit përgjegjës pranë personit juridik për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni.

Për shkeljen e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni do të caktohet masa administrative e veçantë e konfiskimit të armëve dhe municioneve.

Neni 83-c

Vendosjen e një gjobe në vend për shkeljet e parashikuara në dispozitat e nenit 82 paragrafi 2, 83 paragrafi 2 dhe 83-b të këtij ligji, e kryen organi përgjegjës.

XIV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 84

(Neni 84 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005 dhe neni 1 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 47/2006)

Subjektet tregtare që kryejnë prodhimin e armëve dhe municioneve, riparimin e armëve dhe tregtimin e armëve, pjesëve të armëve dhe municioneve, dhe për të cilat deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk nevojitej një leje, kanë për detyrë që brenda 30 ditëve nga dita e fillimit të zbatimit të këtij ligji të paraqesin kërkesën për lëshimin e lejes të përmendur në nenin 47 dhe 55 të këtij ligji.

Neni 85

(Neni 85 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005 dhe neni 1 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 47/2006)

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në ditën e fillimit të zbatimit të rregulloreve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të zbatohen aktet ekzistuese nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 86

(Neni 86 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005, neni 1 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 47/2006), neni 60 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007), neni 19 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 86/2008) dhe neni 18 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010)

Autorizimet për posedim dhe mbajtje arme, lejet për mbajtje arme dhe autorizimet për posedimin e armëve të lëshuara sipas rregulloreve të deritanishme duhet të zëvendësohen brenda dhjetë viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Autorizimet dhe lejet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni do të zëvendësohen në bazë të paraqitjes së kërkesës me shkrim për zëvendësimin e tyre, e cila dorëzohet nga personi fizik apo juridik.

Kur paraqet kërkesën për zëvendësimin e autorizimeve dhe lejeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, personi fizik ose personi juridik e deklaron armën të cilës i referohet autorizimi ose leja pranë personit përgjegjës, sipas vendqëndrimit ose vendbanimit të shtetasit

të huaj dhe selisë së personit juridik, për të realizuar qitjet eksperimentale të armës.

Qitjet eksperimentale të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni realizohen gjatë zëvendësimit të autorizimeve dhe lejes të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni ose gjatë paraqitjes së kërkesës për rinovimin e autorizimit për armë, apo autorizimit për posedimin e armëve, në përputhje me dëshirën e personit juridik apo fizik.

Neni 86-a

(Neni 61 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007 dhe neni 19 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010)

Për armët e kategorive B, C dhe D që disponohen nga personat fizikë apo juridikë pa autorizimin e duhur për armë të parashikuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 26/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003), organi përgjegjës lëshon autorizim për armë, autorizim për posedim arme dhe certifikatë, nëse personi fizik plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 9 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 dhe paragrafi 2 të këtij ligji, apo nëse personi juridik plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 16 paragrafi 1 pika 1 dhe paragrafi 2 të këtij ligji.

Armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk duhet të rezultojnë nga një krim i kryer, apo të kenë qenë me qëllim për t’u përdorur për kryerjen e një krimi, nuk duhet të jenë në pronësi të një personi fizik apo juridik tjetër dhe shenjat e armës nuk duhet të jenë të dëmtuara ose të fshira.

Autorizimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni lëshohen në bazë të kërkesës së personit fizik ose juridik maksimumi brenda një viti nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Nëse personi fizik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 9 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4, 6 dhe 7 dhe paragrafi 2 të këtij ligji, apo personi fizik nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 16 paragrafi 1 pika 1 dhe paragrafi 2 të këtij ligji, atëherë organi përgjegjës e thërret personin fizik apo personin përgjegjës të personit juridik të dorëzojë me vullnetin e tij të lirë armët e paragrafit 1 të këtij neni pranë stacionit të policisë më të afërt me vendin e banimit të tyre ose selinë e personave juridikë.

Gjatë dorëzimit vullnetar të armëve të përmendura në paragrafin 4 të këtij neni nuk do të kryhet identifikimi dhe regjistrimi i personave që dorëzojnë armët me vullnetin e tyre të lirë.

Kundër personave që kanë dorëzuar me vullnetin e tyre të lirë armët e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni nuk do të kryhet ndjekje penale ose kundërvajtjeje.

Armët e kategorisë B dhe C, që posedohen nga një person fizik ose person juridik me autorizimin e duhur për armë të parashikuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 26/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003), mund të dorëzohen vullnetarisht pranë stacionit të policisë më të afërt me vendin e banimit apo selinë e personit juridik, nëse personi fizik ose personi përgjegjës i personit juridik për arsye personale të justifikuara ka ndërmend të dorëzojë vullnetarisht armët.

Neni 86-b

(Neni 61 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007 dhe neni 20 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010)

Personat fizikë apo juridikë që disponojnë armë të kategorisë A, pa autorizimin e duhur për armë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 26/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003), thirren të dorëzojnë vullnetarisht armët.

Thirrja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni bëhet nga ana e organit përgjegjës me thirrje publike.

Personat fizikë apo personat përgjegjës të personave juridikë të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni deklarojnë personalisht se disponojnë armë që kanë ndërmend t’i dorëzojnë vullnetarisht pranë stacionit të policisë me të afërt me vendbanimin e tyre ose selinë e personave juridikë.

Deklarimi i armëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni kryhet çdo të shtunë nga ora 08:00 deri në orën 16:00, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Pas deklarimit të armëve kryhet dorëzimi vullnetar i armëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në mënyrë që zyrtarët e autorizuar të njësisë organizative të organit përgjegjës të realizojnë marrjen e armëve të deklaruara nga vendi ku ruheshin këto armë.

Gjatë dorëzimit vullnetar të armëve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të kryhet identifikimi dhe regjistrimi i personave të cilët kanë dorëzuar vullnetarisht armët.

Kundër personave që kanë dorëzuar vullnetarisht armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të kryhet ndjekje penale ose kundërvajtjeje.

Neni 86-c

(Neni 21 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010)

Për armët e koleksionit që posedojnë personat fizikë pa autorizimin e duhur për armët të parashikuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjit “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 26/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003), organi përgjegjës lëshon autorizim për armët e koleksionit, nëse personi fizik plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 9, 26-a dhe 33 të këtij ligji.

Armët e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, nuk duhet të rezultojnë nga një krim i kryer, apo të kenë qenë me qëllim për t’u përdorur për kryerjen e një krimi, nuk duhet të jenë në pronësi të një personi fizik apo juridik tjetër dhe shenjat e armës nuk duhet të jenë të dëmtuara ose të fshira.

Autorizimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni lëshohen në bazë të paraqitjes së kërkesës nga personi fizik.

Neni 87

(Neni 87 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005), neni 1 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 47/2006) neni 62 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007)

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji procedurat për blerjen, posedimin, mbajtjen, ruajtjen, prodhimin, riparimin, tregtimin dhe transportin e armëve dhe municioneve që kanë nisur në përputhje me ligjin “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 25/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003) do të vazhdojnë të jenë të

zbatueshme sipas dispozitave të ligjit “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme”.

Neni 88

(Neni 88 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005)

Dispozitat e kapitullit X të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen pas pranimit të Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian.

Neni 89

(Neni 89 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005 dhe neni 1 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 47/2006)

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji shfuqizohet ligji “Për blerje, posedim dhe mbajtje arme” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 25/72, 30/72, 18/76, 25/76, 15/83, 51/88 dhe “Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 26/93 dhe 49/2003) dhe nenet nga 22 deri në 31, neni 65 paragrafi 1 pika 5 dhe paragrafi 3, neni 66 paragrafi 1 pikat 3, 4 dhe 5 dhe paragrafi 3 të ligjit “Për kalimin e kufirit shtetëror dhe për lëvizje përgjatë kufirit” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 36/92, 12/93, 11/94 dhe 19/2004).

Neni 90

(Neni 63 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007)

Në tekstin e plotë të ligjit “Për armët” fjala “me vjaska” dhe “pa vjaska” ndryshohen me fjalët “e vjaskuar” dhe “e pavjaskuar”.

Neni 91

(Neni 64 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 42/2007)

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen brenda një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 92

(Neni 20 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 86/2008)

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 93

(Neni 23 i ligjit të shpallur në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” numër 72/2010)

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet ligji “Për dorëzimin vullnetar dhe mbledhjen e armëve të zjarrit, municioneve dhe substancave shpërthyesë dhe për legalizimin e armëve të zjarrit” (“Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 37/2003 dhe 9/2004).